

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5545
E martë, 7 gusht 2018
çmimi 0.40 €

I paqartë fati i Asociacionit pas kalimit të afatit



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**ISMAILI THEMELON
KOMITETIN PËR REVIDIMIN
E LISTËS ESENCIALE
TË BARNAVE** F. 6

**VJOSA DOBRUNA EMËROHET
AMBASADORE NË HAGË** F. 6

**KOMUNA E ISTOGUT NDAN 38
BURSA PËR STUDENTË** F. 10

EKONOMI

**RUKIQI: QEVERIA E KOSOVËS
DUHET T'I MARRË PARASYSH
REKOMANDIMET E BIZNESEVE** F. 9

**GRURI PO DERGJET
NË ARA** F. 9

KULTURË

**MËRGATA PROMOVON
DHJETË LIBRA NË
PRISHTINË** F. 14

SPORT

**GASHI: BESA NUK MË KA
KONTAKTUAR, VUSHTRRIA
DHE FLAMURTARI PO** F. 18

**JAVË VENDIMTARE PËR KB
RAHOVECI** F. 18



FLET PËR "EPOKËN E RE", LUTFI HAZIRI | FAQE 4-5

Mosarritja e konsensusit rrezikon procesin e dialogut me Serbinë

Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lutfi Haziri, ka bërë me dije se mosarritja e konsensusit të gjerë politik rrezikon procesin e dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se me mospërfshirjen e opozitës dhe shoqërisë

civile ky proces do të dalë i pasuksesshëm ose do të dështojë. Haziri ka thënë se do të ishte mirë të arrihet një marrëveshje konsensusi për dialogun me Serbinë, për zgjedhjet e reja, për agjendën evropiane dhe për formimin e ushtrisë. Ai ka mbrojtur qëndrimin e tij

se Lugina e Preshevës duhet t'i bashkohet Kosovës dhe ka bërë me dije se kjo çështje duhet të diskutohet në kuadër të dialogut me Serbinë. Haziri ka paralajmëruar se në vjeshtë Kosova mund të shkojë në zgjedhje të reja pasi, sipas tij, do të ketë angazhime intensive

Veseli: Ndarja e Kosovës asnjëherë nuk do të bisedohet



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka mohuar çdo mundësi të ndarjes së Kosovës në fazën finale të dialogut me Serbinë. Ai i ka siguruar qytetarët e Kosovës se kjo çështje asnjëherë nuk do të lejohet të shtrohet në tavolinën e bisedimeve në Bruksel. Sipas Veselit, debati i fundit për këtë çështje është më tepër garë elektorale, duke shtuar se Republikën e Kosovës nuk do të mund ta cenojë askush | FAQE 3



**Ish-ministrja
Reshitaj
emërohet
këshilltare e
kryeministrit
Haradinaj** | FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Baza e NATO-s në Shqipëri, investim me rëndësi të madhe politike

TIRANË, 6 GUSHT - Zëvendësministri i Mbrojtjes në Republikën e Shqipërisë, Petro Koçi, përmes një shënimi në "Facebook" ka shprehur entuziazëm për lajmin se NATO-ja po ndërton bazë në Shqipëri. Ai shndërrimin e Bazës Ajrore të Kuçovës në një bazë të NATO-s e ka konsideruar investim me rëndësi të madhe politike dhe ushtarake. "Zhvillimi i Bazës Ajrore të Kuçovës nën kujdesin e NATO-s për t'u shndërruar në një

bazë bashkëkohore për qëllime mbështetjeje logjistike për operacionet e furnizimit të forcave ajrore, për mbështetje të operacioneve të patrullimit ajror dhe natyrisht për qëllime stërvitore të forcave ajrore të Aleancës, përbën një investim me rëndësi të madhe politike dhe ushtarake", tha ai. Koçi thotë se ndërtimi i kësaj baze që është e para në Ballkan, dëshmon peshën që ka Shqipëria për sigurinë e këtij rajoni. "Kjo bazë, si e para e këtij lloji në Ballkanin

Perëndimor, dëshmon peshën dhe përparësinë që përfaqëson Shqipëria për sigurinë dhe paqen në rajon si dhe rritjen e pranisë së NATO-s në rajonin tonë në përgjigje të rolit jomiqësor ndaj interesave euroatlantike të vendeve të tilla si Rusia", shkruan kryetari i PSV91. Zëvendësministri i Mbrojtjes ka thënë se ky është lajm shumë i mirë edhe për interesat ekonomike të zonës ku ndërtohet baza.



Ndryshimet në qeveri si makijazh elektoral për zgjedhjet vendore

Sa iu përket ndryshimeve në qeveri, ka dy ngjarje kjo vjeshtë. Ngjarja e parë dhe e mundshme mbetet ndryshimet në qeveri nga kryeministri Rama. Këtë e ka ai në dorë. Ai do t'i bëjë ndryshimet, pasi pikësëpari po vijmë zgjedhjet vendore dhe duhet t'i fitojë, siç do të synonte çdo kryeministër



TIRANË, 6 GUSHT - Edi Rama po projektton ndryshimin e qeverisë. Pak veta, ose më saktë asnjë, i dinë emrat që ikin e ata që do të vijmë në karriget ministore. Hajde po themi se deri-diku vetëm Engjëll Agaçi, sekretar i përgjithshëm i kryeministrit, njeri i besuar i Edi Ramës për çdo veprim kryeministrior; mund të dijë se çka ndërmend të bëjë në këtë vjeshtë shefi i partisë në pushtet. Të tjerët, kushdo thotë apo tregon gjoksin se e di se "ma tha Rama", vetëm sa gënjen ose e bën gjoja për t'u treguar sikur ka dijeni se ç'po thur Edi Rama. Përvoja e këtyre viteve ka treguar, se ndonëse nuk del në skenë, vetëm një njeri ka pushtet mbi Edi Ramën. Ajo është Linda Rama, bashkëshortja. Pushtet është fjalë e madhe kur ke parasysh Edi Ramën, por po

bëjmë kompromisin e fjalës, ajo sugjeron, pasi njeh shumë mirë ekonominë. Njihet publikisht se Linda është një prej emrave më të mirë të botës ekonomike e financiare, por duket se ajo nuk flet, as me gojë e as me mimikë kur del në publik. Pakti duket se ajo mbetet këshilltarja e Edit, por jo zyrtarisht. Në shtëpi, po. Tani duke u kthyer te ndryshimet në qeveri, mund të themi se ka dy ngjarje kjo vjeshtë. Ngjarja e parë dhe e mundshme mbetet ndryshimet në qeveri nga kryeministri Rama. Këtë e ka ai në dorë. Ai do t'i bëjë ndryshimet, pasi pikësëpari po vijmë zgjedhjet vendore dhe duhet t'i fitojë, siç çdo kryeministër do të synonte. Ekonomia dhe mirëqenia popullore nuk janë siç ka premtuar në qershor 2017. Dhe pa mirëqenie nuk ka votues që të jep votën, aq më

tepër se tani nuk ka kujt t'i shfaqësohet. Krejt pushtetin e ka për vete, ndaj edhe krejt votuesit e zhgënjyer, të cilët duken se po shtohen vrullshëm, do t'i japin votë kundër. Vota kundër mund t'i rrezikojë pushtetin ekzekutiv. Ndaj po kërkon të bëjë një makijazh politik për të krijuar një qeveri me emra që nuk janë të botës politike, por nga shoqëria civile, ndonëse prapë janë rilindës e jo nga PS. Ky është një manovër që ndihet nga lëvizjet e tij të fundit. Përballë nuk ka vetëm PD-në në zgjedhjet vendore, por PD-LSI. Nuk duhet harruar se LSI është

forcë përcaktuese në zgjedhjen e kryetarit në çdo bashki si dhe në këshillat bashkiakë. Në Tiranë beteja do jetë vendimtare, si "beteja e Stalingradit". Se kush janë "nazistët" në këtë rast publiku e di mirë! Ndaj ky muaji nuk është krejt plazh me Zahun në Vlorë për kryeministrin apo mësimi noti për djalin e vogël, të cilin këtë të diel e kishte nxjerrë në video. Dhe shumë mirë bën që i mëson notin. Ndërsa për vete, për dreq, nuk noton mirë. E kujton edhe detin si plaçkë, tamam si Marrëveshja e Detit me

Greqinë. Ngjarja e dytë që pritet këtë vjeshtë është ajo që parashikon opozita; rrëzimi me protesta masive i kryeministrit Rama. Por, për dreq, edhe këtë nuk e besoj fort, pasi ndonëse populli mezi pret vjeshtën të "vizitojë" zyrën e kryeministrit të dhe të prekë pikturat në zyrën e Ramës, prapëseprapë lidhshipi demokrat heziton. Ndërsa LSI e do "të pjekur" kryeministrin. Natyrisht që pushteti nuk merret me protesta, por me votë, ndaj si opozitë ka një ide të përbashkët se kryeministri të jetë prapë i PS-së, por jo Edi Rama më të cilin nuk futen në zgjedhjet vendore, pra më atë kryeministër. Kjo skemë do përballje, të cilën populli opozitar e kërkojë që më 23 janar 2018, kur ishin në Bulevard mbi 100 mijë veta. Tani ndodhemi para vjeshtës me dy zgjidhje; një me qeveri të re me fytyra të reja rilindëse, por me kryeministër Ramën dhe varianti i dytë me një qeveri socialiste, por jo me Edi Ramën në krye të saj. Të parën zgjidhje e ka në dorë pikërisht Edi Rama, ndërsa të dytën populli, por nëse lidhshipi demokrat e ka ndarë mendjen.

Partitë shqiptare në Maqedoni, kundër ndarjes së Kosovës

Shkup, 6 gusht - Partitë politike në Maqedoni kundërshtojnë mundësinë e ndarjes së Kosovës, respektivisht të ndryshimit të kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Partia më e madhe në pushtet, LSDM-ja, mbron parimin e mosndarjes së kufijve dhe atë të përmirësimit të raporteve ndërfqinjësore. "LSDM-ja përfaqëson parimin e mosndryshimit të kufijve në Ballkan. Politikat e LSDM-së janë të orientuara drejt integritetit të

mbarë rajonit, ndërtimit të miqësisë, zhvillimit dhe përparimit të raporteve me fqinjët. Vetëm në këtë mënyrë rajoni mund të shkojë përpara drejt zhvillimit, përparimit dhe prosperitetit, që është në interes të gjithë qytetarëve", thuhet në komentën e LDM-së. Nga BDI-ja thonë se tema të këtilla as që duhen diskutuar, pasi rajoni është në rrugë të mbarë për integritim në strukturat euroatlantike. "Kryetari Ahmeti është

prononcuar disa herë në lidhje me temën e imponuar të ndryshimit të kufijve duke thënë se rajoni është në rrugë të duhur të paqes, sigurisë, stabilitetit, integritetit euroatlantik dhe zhvillimit ekonomik. Prandaj skenarët e tillë që mund të nxisin efekt domino në gjithë rajonin nuk duhet të zënë vend në diskursin publik", thuhet në deklaratën e BDI-së. Derisa nga Aleanca për Shqiptarët theksojnë se shqiptarët nuk kanë më territore për të humbur.



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh lider i PDK-së, Kadri Veseli, ka thyer heshtjen në debatin për korrigjimin e kufirit me Serbinë

Veseli: Ndarja e Kosovës asnjëherë nuk do të bisedohet

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka mohuar çdo mundësi të ndarjes së Kosovës në fazën finale të dialogut me Serbinë. Ai i ka siguruar qytetarët e Kosovës se kjo çështje asnjëherë nuk do të lejohet të shtrohet në tavolinën e bisedimeve në Bruksel. Sipas Veselit, debati i fundit për këtë çështje është më tepër garë elektorale, duke shtuar se Republikën e Kosovës nuk do të mund ta cenojë askush



**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 6 GUSHT - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka bërë me dije se ndarja e Kosovës asnjëherë nuk do të bisedohet në fazën finale të dialogut me Serbinë. Ai ka thënë se Kosova është e vendosur të ecë përpara drejt anëtarësimit në OKB dhe BE me kufijtë aktualë. "Ndarje të Kosovës nuk do të ketë. Ndarja e Kosovës nuk do të jetë asnjëherë në tavolinën e bisedimeve të cilat i kemi në dialog. Kosova nuk ka asgjë për të dhënë. Ne do të shkojmë në dialog, jemi të vendosur të ecim përpara për anëtarësimin e Kosovës në OKB, BE dhe në institucionet e tjera euroatlantike të cilat janë interes strategjik yni", ka thënë Veseli të hënën pas takimit me kryetarin e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK), Arian Zeka.

Lideri i PDK-së debatin për këtë çështje e ka vlerësuar si garë elektorale, duke i siguruar

qytetarët e Kosovës se askush nuk do ta cenojë shtetin e Kosovës. "Debati që është ngjallur është më tepër një garë elektorale, në të njëjtën kohë ka shumë të pavërteta, shumë inati dhe nuk është duke i ndihmuar substancës të cilën ne jemi të përkushtuar për shtetin tonë të pavarur dhe sovran, drejt OKB-së dhe BE-së. Është duke krijuar një pasiguri dhe një frikë e cila është e paqenë. Po e ritheksoj edhe një herë, se askush nuk duhet të frikësohet nga dialogu. Dialog do të thotë sovranitet dhe integritet territorial i Republikës sonë. Dialog do të thotë fqinjësi e mirë, siguri për qytetarët tanë, për gjeneratat e ardhshme. Në të njëjtën kohë, ne nuk kemi pasur kurrë partner më të mirë sesa ShBA-në dhe BE-në. Kurrë nuk kemi qenë në pozitë më të mirë për të dialoguar me çdo vend. Siguria është maksimale se askush asnjëherë Kosovën tonë nuk do ta cenojë", ka deklaruar Veseli.

Të hënën edhe një herë presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka folur rreth propozimit të tij për

korrigjim kufijsh. Presidenti Thaçi përmes një postimi në llogarinë e vet në "Twitter" ka shkruar se propozimi i tij nuk ka të bëjë me ndarje, por me rregullim të kufijve. "Propozimi im për një zgjidhje paqësore me Serbinë është i qartë: jo ndarje në vija kufitare, por po për korrigjimin e kufirit dhe njohje reciproke", ka shkruar Thaçi. Shefi i shtetit javën që lamë pas në një konferencë për medie është zotuar se në fazën finale të dialogut me Serbinë do ta paraqesë çështjen e korrigjimit të kufirit ndërmjet dy vendeve.

Ai ka thënë se korrigjimi i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do ta ketë mbështetjen ndërkombëtare, nëse arrihet që kjo çështje të përfshihet në marrëveshjen përfundimtare. "Institucionet tona nuk bën t'i mbyllin sytë dhe ta injorojnë një mundësi të tillë historike dhe të papërsëritshme. Duhet të bashkohemi dhe t'i themi po kësaj kërkesë krejt racionale, të drejtë dhe historike, e cila ka mundësi të realizohet krejtësisht në mënyrë paqësore", ka thënë Thaçi, duke shtuar se korrigjimi i kufirit nuk do të thotë bashkim i

Kosovës me Shqipërinë. Kjo ide e presidentit ka nxitur debate të shumta në opinionin publik, ku partitë në pushtet dhe ato në opozitë kanë qëndrime të ndryshme. Kryeministri Ramush Haradinaj dhe zëvendësi i tij Fatmir Limaj kanë dalë kundër idesë së korrigjimit të kufirit me Serbinë, duke thënë se një gjë e tillë nuk i duhet Kosovës. Edhe LDK-ja e ka kundërshtuar këtë ide, kurse Lëvizja për Bashkim e ka përkrahur idenë e presidentit Thaçi për korrigjim të kufirit me Serbinë.

I paqartë fati i Asociacionit pas kalimit të afatit

PRISHTINË, 6 GUSHT - Qeveria e Kosovës është duke pritur që draftstatuti për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, që dorëzohet në Bruksel nga ekipi menaxhues, të jetë i bazuar në Kushtetutën e Kosovës. Zyrtarët thonë se deri më tash nuk kanë pranuar ndonjë dokument final për statutin.

Data 4 gusht ishte afati i fundit kur ekipi menaxhues i formuar për këtë çështje është dashur ta dërgojë në Bruksel draftin e parë të statutit të Asociacionit. "Pritjet tonë janë që ky draft të jetë i bazuar apo në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kjo është pritja jonë. Dhe ky proces është një obligim i një marrëveshjeje ndërkom-



bëtare që ka Kosova, të përfundojë sa më shpejt", ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" Donjeta Gashi, zëdhënëse e Qeverisë së Kosovës.

Ndërsa Ministria e

Administrimit të Pushtetit Lokal ka konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" se statuti i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe do të dorëzohet në Bruksel nga ekipi për

hartimin e draft-statutit.

Në një përgjigje me shkrim nga Ministria thuhet se "raporti nga mbledhja e fundit e mbajtur nga ekipi menaxhues të hënën dorëzohet në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal [MAPL] dhe menjëherë porsa të përkthehet do të dërgohet në kabinetin e kryeministrit".

Në përgjigjen nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, theksohet se herën e kaluar Zyra e Kryeministrit e ka kthyer raportin prapa për arsye se ka qenë vetëm në gjuhën serbe. Zyrtarët në ministri thotë se sapo të përkthehet do të procedohet në instancat përkatëse.

Zëdhënësjë e Qeverisë, Donjeta Gashi, ka bërë me dije se Qeveria

e Kosovës ende nuk ka pranuar ndonjë dokument të ri nga grupi menaxhues për hartimin e statutit.

Themelimi i Asociacionit apo Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe është produkt i marrëveshjeve të Brukselit, të arritura në kuadër të dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit me lehtësimin e Bashkimit Evropian.

Qeveria në Prishtinë e sheh këtë organ si një Asociacion me kompetenca joekzekutive. Përderisa Beogradi dhe përfaqësuesit e serbëve në Kosovë, pretendojnë se Asociacioni, apo siç e quajnë, Bashkësia e Komunave Serbe, të ketë edhe kompetenca ekzekutive.

Flet për "Epokën e re", Lutfi Haziri

Mosarritja e konsensusit rrezikon

Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lutfi Haziri, ka bërë me dije se mosarritja e konsensusit të gjerë politik rrezikon procesin e dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se me mospërfshirjen e opozitës dhe shoqërisë civile ky proces do të dalë i pasuksesshëm ose do të dështojë. Haziri ka thënë se do të ishte mirë të arrihet një marrëveshje konsensusi për dialogun me Serbinë, për zgjedhjet e reja, për agjendën evropiane dhe për formimin e ushtrisë. Ai ka mbrojtur qëndrimin e tij se Lugina e Preshevës duhet t'i bashkohet Kosovës dhe ka bërë me dije se kjo çështje duhet të diskutohet në kuadër të dialogut me Serbinë. Haziri ka paralajmëruar se në vjeshtë Kosova mund të shkojë në zgjedhje të reja pasi, sipas tij, do të ketë angazhime intensive

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 6 GUSHT -

"Epoka e re": Z. Haziri, tashmë edhe në opinionin publik po flitet për korrigjimin e kufirit me Serbinë. E mbështet këtë ide Lidhja Demokratike e Kosovës?

Haziri: Dialogu Kosovë - Serbi është proces me të cilin po merret jo vetëm opinioni në Kosovë, por edhe faktori ndërkombëtar. Tani në Kosovë po përdoret shumë terminologjia ndarje dhe shkëmbim i territoreve, por këtu kemi të bëjmë me shumë me një proces normalizimi i cili në fund çon tek rishikimi i kufirit të vitit 1974 mbi bazën e të cilit është shpallur pavarësia e Kosovës me mundësi që Kosova Lindore në përputhje me referendumin e saj të bëhet pjesë e Republikës së Kosovës. LDK-ja e ruan parimin e mosndryshimit të kufijve dhe ruajtjes së Kosovës së 17 shkurtit 2008. Tërësia territoriale, sovraniteti i Kosovës dhe respektimi i të drejtave të pakicave mbetet pjesë e politikës së LDK-së, politikë kjo e pandryshuar deri më tani.

"Epoka e re": Që do të thotë se nuk e përkrahni idenë për korrigjim të kufirit?

Haziri: Që do të thotë se LDK-ja nuk përkrah ide tjetër. LDK-ja nuk është pjesë e dialogut në formatin që presidenti Thaçi po e udhëheq. LDK-ja do të jetë opozitë në Kuvend dhe me mjete opozitare do të vazhdojë ta kundërshtojë këtë mënyrë të dialogut. Ushtrimi i rolit opozitar në Kuvend do të jetë determinues për të ardhmen e dialogut.

"Epoka e re": Këtë kundërshtim po e bëni për shkak se korrigjimi mund të ketë pasojë për vendin apo për shkak se ky proces po udhëhiqet nga presidenti?

Haziri: Si nënkryetar e kam ndarë mendimin tim, e mbështes qëndrimin e LDK-së sepse shumica mendojnë

ashtu. Ndërsa personalisht si Lutfi Haziri mendoj se zgjidhja e problemit me Serbinë është territorial, pra duhet të definohet qartë territori dhe kufiri në mënyrë që mos të kemi probleme në të ardhmen. Serbia e sheh Kosovën problem territorial. Kosova për momentin është shembulli më i mirë sa iu përket të drejtave të komuniteteve pakicë, në këtë rast i komunitetit serb, sepse serbët kanë të drejta asimetrike karshi të tjerëve. Por se sa i shfrytëzojnë këto të drejta serbët është çështje tjetër. Prandaj Serbia është e pakënaqur me shkallën e të drejtave të serbëve në Kosovë, sepse Kosovën e sheh si preh territoriale dhe ky është raporti që duhet të definohet. Askush nuk është për dhe nuk bën të bëjë ndërrime klasike Mitrovicën me Preshevën, Bujanocin e Medvegjen. Të gjithë ata që flasin kështu dëshirojnë të çojnë kërcënim në proces dhe dëshirojnë ta frikësojnë popullin. Bistrica, Boletini, Mitrovica dhe Zveçani janë pjesë e pandashme prej Kosovës, por pjesë e Kosovës duhet të bëhet edhe Presheva, Bujanoci dhe Medvegja.

"Epoka e re": Si mund të bëhet pjesë e Kosovës Lugina nëse nuk ka korrigjim të kufirit apo shkëmbim të territoreve?

Haziri: Kjo çështje duhet të diskutohet në kuadër të dialogut. Nuk duhet të frikësohemi, nuk duhet të çojmë frikë te populli, por duhet një konsensus sa më i gjerë politik, një format më gjithëpërfshirës në dialog ku është e kënaqur edhe opozita me statusin e saj. Para Serbisë duhet të dalim si delegacion unik, i përgjegjshëm dhe shtetformues, duke paraqitur interesin nacional para interesave politike e partiake në mënyrë që të dalim sa më të suksesshëm nga dialogu. Në të kundërtën, Kosova mbetet kjo që është, nuk bëhet as më e mirë as më e keqe sepse 17 shkurti nuk mund të rikthehet mbrapa dhe Kosova e vitit 1974 është e pranuar ndërkombëtarisht.

"Epoka e re": Ju po thoni se në kuadër të dialogut Lugina duhet t'i bashkohet Kosovës, po ashtu po thoni se Serbia ka pretendime territoriale ndaj Kosovës. Si do të jetë e mundshme që Serbia të pranojë që Lugina t'i bashkohet Kosovës pa marrë asgjë në këmbim të saj?

Haziri: Është çështje e saj çfarë ka në plan dhe çfarë kërkon. Për ne është shumë e qartë se çfarë kërkon Serbia. Serbia kërkon Kosovën në lumin Ibër në Mitrovicë dhe në lumin Morava në Gjilan. Dhe, deri këtu është duke e kontrolluar territorin në një formë apo në një formë tjetër. Por, kjo është e papranueshme dhe duhet bërë e qartë. Duhet të jemi të vetëdijshëm se çfarë kërkon Kosova, çfarë është e jona dhe çfarë është e mundshme të realizohet. Se çfarë lyp Serbia është problem i saj. Edhe në Vjenë ka kërkuar dhe ka dashur shumë, por nuk ka marrë asgjë, edhe në kohën e Rambujesë krejt Kosova ka qenë e pushtuar nga forcat ushtarake e policore, mirëpo janë detyruar të largohen, janë demontuar politikisht, institucionalisht dhe ushtarakisht prej Kosovës. Nuk duhet të frikësohemi prej proceseve në tavolinë. Në tavolinë fitojmë gjithmonë sepse kemi fakte dhe argumente. Kosova duhet t'i frikësohet vetëm konfliktit eventual, sepse ushtarakisht Serbia është më e fortë jo vetëm se Kosova, por se shumica e shteteve në Ballkan.

"Epoka e re": Sa është e realizueshme mundësia që Lugina t'i bashkohet Kosovës?

Haziri: Duhet pasur vetëm vullnet politik dhe ëndrra e shqiptarëve të Luginës së Preshevës bëhet shumë shpejt realitet. Si duket, Prishtina zyrtare nuk e njeh mirë problemin e shqiptarëve të Kosovës Lindore, nuk e ndien politikisht dhe nuk është duke parë territorialisht rëndësinë e shqiptarëve dhe tokës së mbetur në Serbi. Kur ka qenë në pyetje demarkimi i kufirit të Kosovës me Maqedoninë ata i falën 800



hektarë tokë, për Çakorr tri vjet e gjysmë skena politike në Prishtinë ka organizuar demonstrata të dhunshme duke u frikësuar se Kosova po humbet një pjesë të kufirit me Malin e Zi, ndërsa kur vjen puna e demarkimit të kufirit me Serbinë ata mbjellin frikë të shqiptarët se po humbet veriu për Luginën e Preshevës. Shqiptarët e Kosovës si në Bistricë, në Boletinë, Mitrovicë, në Zveçan, në Gjilan e Istog janë brenda territorit të Kosovës dhe këtu më nuk është problemi. Por problemi është se ku kanë mbetur shqiptarët e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjes dhe këtu duhet të zgjidhet problemi dhe t'i vendoset pika.

"Epoka e re": Mundësia e

bashkimit të Luginës së Preshevës me Kosovën në kuadër të dialogut me Serbinë do të ndikojë te LDK-ja që të bëhet pjesë e këtij procesi apo përfundimisht LDK-ja në asnjë rrethanë nuk ndryshon qëndrim?

Haziri: Deri në këtë fazë qëndrimi i LDK-së është unik. LDK-ja nuk është pjesë e dialogut sepse nuk është arritur konsensusi në Kuvend. Kemi kërkuar që çështja e dialogut të vijë në Kuvend dhe pas një debati Kuvendi t'i vendosë parimet, formatin, agjendën dhe për pritjet e Kosovës nga ky dialog. Një gjë e tillë nuk ka ndodhur dhe me vetë faktin se organi më i lartë është anashkaluar prej dialogut. LDK-ja e ka parë veten jashtë këtij procesi. Kosova duhet të ndërtojë

procesin e dialogut me Serbinë



konsensus politik dhe duhet të hyjë e përgatitur në proces zgjedhor për të cilin detyrimisht në këtë vjeshtë do të ketë angazhime intensive.

"Epoka e re": LDK-ja po kërkon që njëherë të mbahen zgjedhjet, pastaj të bëhet pjesë e dialogut me Serbinë. A do të ketë kohë të mjaftueshme që të mbahen zgjedhjet, të krijohen institucionet e reja e pastaj të vazhdohet dialogu?

Haziri: Legjitimiteti para dialogut nuk është duke u shqyrtuar nga partitë që janë në pushtet, madje nuk është as duke u nënvizuar si kërkesë e LDK-së. Ne duhet të bisedojmë për zgjedhjet e planifikuara nëse jo atëherë mocioni i mosbesimit mbetet mekanizëm kushtetues që mund

të iniciohet në çdo kohë dhe për 40 ditë vendi shkon në zgjedhje. Por aktualisht në Kuvend nuk e kanë shumicën as partitë që janë në qeverisje e as opozita. E mira e këtij procesi është që të gjendet një rrugë e mençur me anë të së cilës do të arrihet një marrëveshje konsensusi për dialogun, për zgjedhjet, për agjendën evropiane edhe për formimin e ushtrisë sepse këto janë procese të mëdha për të cilat pozita duhet të pajtohet detyrimisht me opozitën.

"Epoka e re": LDK-ja do ta marrë përgjegjësinë pavarësisht prej epilogut të dialogut?

Haziri: Nuk ka qartësi. Ende formati i dialogut është vetëm në nivel të presidentëve dhe pritet që në shtator BE-ja si ndërmjetëse e këtij procesi të japë qartësi për

formatin, agjendën dhe për oraret. Praktikisht deri në shtator kur do të ketë një qartësi të këtij dialogu, pozitat janë këto që i shpjeguam. Pozitat nuk i ka ndryshuar asnjëra palë.

"Epoka e re": Mund të ndryshojë pozicioni i LDK-së në shtator kur pritet të ketë një dinamizëm të dialogut?

Haziri: Dialogu është i vetmi mjet për zgjidhjen e problemeve. Jemi pro dialogut për zgjidhjen e problemeve me fqinjët dhe pro dialogut për zgjidhjen e problemeve të brendshme, por ky raport nuk ndryshon përderisa nuk kemi progres në atë që ne e quajmë zgjedhje të planifikuara apo edhe zgjedhje të parakohshme. Mirëpo edhe më tutje jemi në pritje të zgjedhjeve të planifikuara.

"Epoka e re": Ka rrezik që Kosova të dalë humbëse nga formati aktual i dialogut dhe veriu të fitojë një lloj autonomie?

Haziri: Kosova me mbështetjen e ShBA-së si partnere dhe me ndërmjetëse sikur BE-ja në asnjë rast dhe në asnjë rrethanë nuk mund të humbë sepse të gjitha faktet dhe argumentet janë në anën e Kosovës. Detyrimisht mosarritja e një konsensusi më të gjerë, mospërfshirja e opozitës dhe shoqërisë civile në dialog e rrezikon procesin dhe procesi do të dalë i pasuksesshëm ose do të dështojë. Ne kërkojmë që Serbia ta largojë Kosovën nga kushtetua serbe, të largohet nga miti i rrëzshëm në mënyrë që të zhvillohet partneriteti i fqinjësisë së mirë dhe jo raporti i luftës. Është politikë e podrumeve nëse mendohet

që serbët mund të shpallin ndonjë akt juridik në veri. Për ata nuk ekziston pavarësia e Kosovës dhe as Republika e Kosovës meqë, sipas Kushtetutës së Serbisë, Kosova është pjesë e tyre. Shqetësimi më i madh është se de facto përmes kryetarit të Komunës së Mitrovicës veriore dhe koordinitorit të Listës Serbe ata e kontrollojnë verium e Kosovës në çdo aspekt dhe kjo është e keqja. Në veri kemi të bëjmë me moszbatim të ligjit. Kosova shpenzon milionë euro në mirëmbajtje të blerjes së paqes politike dhe sociale, ndërsa me ato para lulëzon krimi i organizuar, korrupsioni si dhe mafia ruso-serbe. Problemin e kemi para hundëve, siç thotë populli, dhe ai duhet të lexohet dhe të zgjidhet drejt.

Vjosa Dobruna emërohet ambasadore në Hagë

PRISHTINË, 6 GUSHT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka emëruar ambasadore në Hagë për katër vjet Vjosa Dobrunën. "Përfaqësimi politik dhe diplomatik i Kosovës në vendet perëndimore është

tejet i rëndësishëm. Puna e Vjosa Dobrunës për katër vjet ambasadore në Hagë është kontribut i çmueshëm për diplomacinë e Kosovës", ka thënë Haradinaj. Kryeministri ka falënderuar Dobrunën për angazhimin

profesional që ka dhënë deri më tani, duke i shprehur nevojën dhe interesimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, që roli dhe përvoja e saj të vazhdojnë të shërbejnë për interesat institucionale të vendit.



'PROBLEMI' KOSOVË - SHQIPËRI, I SHPIFUR



Shkruan: Jakup KRASNIQI

Për njerëzit me njohuri mesatare e, mbase, edhe me përgjegjësi mesatare, Shqipëria dhe Kosova problemin shëkullor e kryesor e kanë me Serbinë e jo njëra me tjetrën. "Problemi" i shfaqur në medie mes Thaçit e Berishës, mes dy "miqve" të vjetër, është si lufta e Bali Katravellës me mullit e erës?!

Deklarata e Sali Berishës për deklaratën e papërgjegjshme të Thaçit për Preshevën ishte një goditje e saktë, ndonëse nuk jam prej atyre që e vlerësoj Berishën për goditje të sakta. Por, edhe në këtë rast u vërtetua ajo thënia e njohur e popullit: "S'ke nevojë që të kesh armiq, mjafton ta thuash të vërtetën që t'i krijosh ata"! Përgjigja që Thaçi i dha Sali Berishës është përgjigje më shumë se idhnake. Madje, edhe po të ishte e vërtetë ajo që Thaçi e tha për të, pse duhej të thuhej më kaq shumë vonesë?! Kur dihet se Millosheviqi, Bin Ladeni dhe Arkani më nuk janë në jetë? A mos po del në këtë rast sedra e Thaçit

mbi interesin e kombit? A kështu na qenka udhëheqësi i pagabueshëm e "ylli i shekullit"? Si po shkruajnë autorët e huaj e të blerë nga Thaçi? Ky Thaçi po del që të jetë me sedër të madhe, me inat të papërmbajtshëm ndaj një mendimi të kundërt të një miku të tij, siç ka deklaruar vetë shumë herë, pse në rastin e Kosovës mos ta vinte edhe interesin e tij mbi interesin e Kosovës e Preshevës marrë së bashku? Mbase, sjellja e tij me miqtë në këtë mënyrë sikur i është bërë traditë. Pozicioni personal i Thaçit është pozicion për ruajtjen e miqve të vjetër dhe krijimin e të rinjve dhe

jo vetëm brenda kombit. Ai gjatë këtyre viteve ka krijuar shumë armiq në Kosovë sa ka mbetur i rrethuar vetëm me armiqtë e tij të djeshëm të cilëve po u shpërndanë pozita shtetërore si të ishin ato karamelle se për dekorime e medalje mos të flasim?! Kjo gjuhë e vendosur në komunikimet e politikës shqiptare nuk nderon njeri e më së paku njerëzit me përgjegjësi shtetërore. Edhe gjuha që u përdor nga një medie shqiptare e Shqipërisë për Thaçin ishte e të njëjtit nivel. Mbase këto medie partizane, të cilat janë me bollëk, janë krijuar nga "udhëheqësit" e këtij niveli! Si është politika tek ne, janë edhe

mediet si krijesa të këtij niveli, as profesionale as intelektuale e njerëzore! Koha është duke kërkuar që më shumë se kurrë, si nga politika ashtu edhe mediet që me gjithë kapacitetet e tyre profesionale e kombëtare të vihen në shërbim të kombit dhe atdheut. Koha e kërkon bashkimin e territorit e jo shkëmbimin e një hapësire shqiptare me një tjetër! Së pari duhet garantuar mirë atë që e ke, pastaj syno edhe të pamundshmen për ta arritur të mundshmen! Kjo gjuhë komunikimi që kanë instaluar disa politikanë shqiptarë nuk prodhon suksesin. Ndryshimi është bërë domosdoshmëri.

Ismaili themelon komitetin për revidimin e listës esenciale të barnave

PRISHTINË, 6 GUSHT (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka njoftuar se ka nënshkruar vendimin për themelimin e komitetit për revidimin e listës esenciale të barnave. Sipas tij, ky vendim është nënshkruar në bashkëpunim të plotë me të gjitha institucionet shëndetësore, shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë. "Edhe një hap më afër revidimit të listës esenciale të barnave. Në bashkëpunim të plotë me të gjitha institucionet shëndetësore, shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë, sot nënshkrova vendimin për themelimin e komitetit teknik, që do ta bëjë revidimin e listës esenciale, e cila nuk është bërë nga viti 2012. Për të qenë tërësisht transparentë, të gjithë hapat në këtë



proces do të publikohen në uebfaqen e MSh-së, kurse për të shmangur çfarëdo konflikti të interesit, ne kemi ftuar Agjencinë Kundër Korrupsionit të kontribuojë dhe ta monitorojë revidimin e kësaj liste", ka thënë ministri Ismaili. Ai ka shtuar se revidimi i listës esenciale të barnave do të bëhet gjatë këtij viti dhe në fund do të jetë një listë me kosto të përballueshme dhe që përmbush nevojat kryesore të popullatës.

Tahiri: Prekja e kufijve çon në luftë

PRISHTINË, 6 GUSHT - Ish-ministrja e Dialogut, Edita Tahiri, ka thënë se sa më shumë që afrohem te finalja e dialogut, Serbia del me skenarë të rrezikshëm dhe këta janë pikërisht skenarë të mundësisë së ndarjes së Kosovës apo të shkëmbimit të territoreve. "Këto të gjitha kanë të bëjnë me ambicie të Serbisë e cila edhe sot synon krijimin e Serbisë së Madhe në dëm të shteteve të tjera, në këtë rast në dëm të Kosovës dhe kombit shqiptar dhe janë të nxitura edhe nga agjendat gjeopolitike ruse. Pavarësisht prej skenarëve të rrezikshëm të Serbisë, Kosova është e vendosur dhe në dialog do ta mbroje sovranitetin, integritetin territorial dhe çfarëdo marrëveshje finale që mund të dalë nga dialogu i Brukselit duhet të jetë dhe do të jetë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës", ka thënë Tahiri në një intervistë dhënë gazetares së RTSh-së, Mimoza Haxhiaj. Duke folur rreth shkëmbimit të territoreve me Serbinë, Tahiri ka thënë se prekja e kufijve do ta



krijonte mundësinë e ndonjë lufte të re. "Këto janë të nxitura nga Serbia, por unë jam e bindur që janë të mbështetura nga Rusia e cila ka një rikthim të ambicieve gjeopolitike ndaj Ballkanit. Por, një mesazh që duhet t'i dërgohet faktorit ndërkombëtar është se prekja e kufijve të Kosovës çon në luftë sepse Ballkani është i njohur që nuk bën prekje kufijsh apo ndryshim kufijsh në forma të tjera dhe e dyta që në rastin e

Kosovës nuk mund të flasim vetëm për shtetin e Kosovës, por duhet ta shikojmë edhe kombin shqiptar, nëse preken kufijtë në Ballkan, duhet të preken për të gjithë Ballkanin dhe me këtë rast edhe të gjithë shqiptarët do të ishin të hapur për të biseduar, por prekja parcale e kufijve do të krijonte një efekt domino me efekte destabilizuese deri në mundësinë e ndonjë lufte të re në mes të Kosovës dhe Serbisë", ka thënë Tahiri.

Mërgata promovon dhjetë libra në Prishtinë

Prishtinë, 6 gusht (ER) - Ministria e Diasporës ka mbajtur të hënën një orë letrare e cila është quajtur "Promenadë mërgimtare". Ky takim është organizuar nga Lidhja e Krijuesve Mërgimtarë dhe kishte për qëllim promovimin e librave të krijuesve shqiptarë që jetojnë larg vendlindjes. Ky takim ka nisur me një minutë heshtje në nderim të veprimtar-

it të çështjes kombëtare, Adem Demaçi, regjisorit Bekim Lumi dhe shkrimtarit Ragip Sylaj të cilët kanë ndërruar jetë muajin e kaluar. Kryetari i Lidhjes së Krijuesve Mërgimtarë, Hasan Qyqalla, ka thënë se ky organizim është jubilar për arsye se është viti i tetë që po mbahen takime të llojit të tillë. Ndërsa zëvendësiministri i Ministrisë së Diasporës,

Faruk Nura, ka thënë se kjo ministri po bën gjithçka që është e nevojshme dhe e domosdoshme për këtë fushë. Ndërsa Halil Matoshi, këshilltar i kryeministrit Ramush Haradinaj, ka thënë se ka marrë pjesë në këtë takim me kërkesë të shefit të Qeverisë për t'u uruar mirëseardhje krijuesve nga mërgata. Gjatë kësaj ore letrare janë promovuar 10 libra.



Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike ka dalë me raport final rreth incidentit të aeroplanit turk të kompanisë "Turkish Airlines" dy vjet më parë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari"

Aeroplani turk doli nga pista e ANP 'Adem Jashari' si shkak i gabimit të pilotit

Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike ka përfunduar hetimet rreth incidentit të aeroplanit turk të kompanisë "Turkish Airlines" i cili më 2 maj të vitit 2016 doli nga pista pas aterimit në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari". "Epoka e re" ka arritur ta sigurojë raportin final profesional të këtij komisioni ku thuhet se aeroplani e kaloi pragun e pistës 35 rreth 80 ft, që i bie rreth 30 ft më lart se lartësia normale e kalimit të pragut. "Kjo çoi në një aterim të gjatë, rreth 100 metra përtej zonës së prekjes në tokë, që i bie rreth 1 030 metra përtej pragut të pistës", thuhet në raport



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 6 GUSHT - Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike ka përfunduar hetimet rreth incidentit të aeroplanit turk të kompanisë "Turkish Airlines" i cili më 2 maj të vitit 2016 doli nga pista pas aterimit në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari". Gazeta "Epoka e re" ka arritur ta sigurojë raportin final profesional të Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike mbi incidentin e

aeroplanit Boeing B737-800, TC-JFY në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", më 2 maj 2016. Në raport thuhet se faktorët shkaktarë të këtij incidenti ishte lartësia shumë e madhe e kalimit të pragut të pistës nga piloti, kombinuar me pozicionimin e gjatë të aterimit dhe prekjen e vonuar në tokë përtej zonës së prekjes në tokë. "Më 2 maj 2016 në orën 19:31 aeroplani doli nga hapësira operative pas aterimit në pistën 35 në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës 'Adem Jashari'. Aeroplani u ndal në bari afër pistës. Të gjithë pjesëtarët e

ekuipezhit dhe pasagjerët në bord shpëtuan pa lëndime, përveç gjashtë pasagjerëve që kërkuan ndihmë mjekësore për shkak të shqetësimit dhe frikës", thuhet në raportin e Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike.


Ky raport është miratuar nga Bordi i KHAIA-s dhe tashmë i është dorëzuar Qeverisë së Kosovës dhe Kuvendit. Në këtë raport më tej bëhet me dije sipas informacioneve më të fundit për erën nga kontrollori i kullës dhe 'Metar' aktual, ekuipezi i fluturimit ishte i vetëdijshëm për gjendjen e motit në aeroport. Të gjeturat e Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike janë këto: Gjatë afrimit të dy anëtarët e ekuipezhit të kabinës e kishin vërejtur që po shkonin shumë lart mbi shtegun e afrimit; Aeroplani e kaloi pragun e pistës 35 rreth 80 ft, që i bie rreth 30 ft më lart se lartësia normale e kalimit të pragut. Kjo çoi në një aterim të gjatë, rreth 100 m përtej zonës së prekjes në tokë, që i bie rreth 1030

m përtej pragut të pistës; CRM-ja gjatë fluturimit nuk ishte në përputhje me procedurat standarde të operimit të operatorit; Shpejtësia ajrore me rastin e prekjes në tokë ishte rreth 5 nyje më lart se VREF dhe shpejtësia tokësore në atë kohë ishte 162 nyje; Sipas analizave të erës nga operatori i linjës ajrore, komponenti i erës në drejtim të njëjtë me fluturimin ishte rreth 13 nyje, por brenda vlerës maksimale të lejuar të erës në drejtim të njëjtë me fluturimin; Ekuipezi i fluturimit u mundua të kalonte nga pista në pistën taksi me shpejtësi mbi shpejtësinë normale taksi. "Faktorët shkaktarë shkak i këtij incidenti serioz ishte lartësia shumë e madhe e kalimit të pragut të pistës, kombinuar me pozicionimin e gjatë të aterimit dhe prekjen e vonuar në tokë përtej zonës së prekjes në tokë. Rezultati ishte prekja në tokë rreth 1030 m përtej pragut të pistës 35. Menaxhimi i burimeve të ekuipezhit nuk ishte në përputhje me PSO-në e operatorit. Ekuipezi i fluturimit nuk ndërmori me kohë

procedurën e kthimit. Kjo do të kishte parandaluar daljen nga pista", thuhet në të gjeturat e raportit të Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike.

Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA) është themeluar në bazë të Ligjit nr. 03/L- 051 për Aviacionin Civil. KHAIA është përgjegjëse për hetimin e aksidenteve dhe incidenteve në aviacion brenda Kosovës ose ku përfshihen avionët e regjistruar në Kosovë, kudo qofshin ata.

KHAIA bënë hetim në mënyrë të pavarur dhe në koordinim të plotë ndërmjet palëve të përfshira. KHAIA është e autorizuar të kërkojë nga cilido autoritet publik i Kosovës dhe/ose person privat ose organizatë në Kosovë që t'i japë asaj përkrahjen e nevojshme për kryerjen e një hetimi të përcaktuar me ligjin për aviacionin civil ose një hetimi i cili kërkohet sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare ose organizate ndërkombëtare të aviacionit.



Ish-ministrja Reshitaj emërohet këshilltare e kryeministrit Haradinaj

PRISHTINË, 6 GUSHT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, e ka emëruar ish-ministren e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, këshilltare politike. Sipas Haradinajt, Reshitaj e ka pranuar ofertën e tij. "Pas lirimit nga detyra e ministres së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, znj. Albena

Reshitaj, kam konsideruar se njohuritë dhe përvoja e saj institucionale janë me rëndësi që të vazhdojnë të jenë në shërbim të qytetarëve të Republikës së Kosovës", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se si kryeministër i Qeverisë është i bindur se kontributi i ish-ministres Reshitaj është i nevojshëm. "Andaj

i kam ofruar asaj postin e këshilltares politike, ofertë kjo të cilën ministrja e ka pranuar. Jam i bindur se vazhdimi i bashkëpunimit institucional me zonjën Reshitaj është në interes të qytetarëve dhe në funksion të implementimit të programit qeverisës. Zonjës Reshitaj i uroj punë të mbarë", ka thënë Haradinaj.



Rukiqi: Qeveria e Kosovës duhet t'i marr parasysh rekomandimet e bizneseve

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukqi, ka thënë se Kosova është i vetmi vend që i ngarkon me akcizës dhe taksë prodhuesit e pijeve alkoolike dhe joalkoolike. Sipas tij, kjo duhet të ndryshohet dhe Qeveria e Kosovës duhet t'i marr parasysh rekomandimet e prodhuesve vendorë



EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 GUSHT - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukqi, ka mbajtur të hënën konferencë për medie, në të cilën ka folur për problemet me të cilat po ballafaqohen prodhuesit e ujit dhe sektori i pijeve joalkoolike dhe alkoolike. Rukiqi ka kërkuar largimin e akcizës për pijet alkoolike dhe ato joalkoolike për prodhuesit vendorë në mënyrë që këta të jenë konkurrentë në eksport. Ai ka bërë me dije se vendet e rajonit nuk kanë një akcizë të tillë.

Kreu i OEK-ut ka thënë se asnjë agjendë politike s'duhet ta pengojë aspektin ekonomik të vendit.

Ai ka shtuar se vëmendja e Odës Ekonomike do të jetë te prodhimi, eksporti dhe shkalla e lartë e papunësisë. "Ky mandat do ta ketë vëmendjen te prodhimi pasi vetëm përmes prodhimit mund të krijojmë vende të punës. Eksporti dhe shkalla e lartë e papunësisë mbesin dy problemet kryesore, prandaj fokusi i Odës Ekonomike të Kosovës do të jetë në evitim të këtyre problemeve", është shprehur ai. Po ashtu, Rukiqi ka pohuar

se sektori i cili krijon një zinxhir të multiplikimit ekonomik është ai i pijeve alkoolike. "Sa i përket sektorit të prodhimit, jemi fokusuar te një sektor i cili kërkon rregullim, pasi ky sektor ndikon drejtpërsëdrejti në rritjen e punësimit dhe ka efekte zinxhirore në ekonominë e vendit, duke ndikuar kështu që ta rrisë edhe eksportin, pra ky sektor është sektori i pijeve alkoolike dhe joalkoolike", ka deklaruar Rukiqi.

Ai ka theksuar se çështja e taksës ujore dhe akcizës janë sfidat kryesore që e përcjellin sektorin e pijeve alkoolike dhe joalkoolike. Sa i përket borxhit për prodhuesit të ujit prej 57 milionë eurosh, për të cilin Qeveria pati marrë vendim për faljen e këtij borxhi, kreu i OEK-ut ka thënë se ky vendim duhet të analizohet dhe të qartësohet shuma nga organet kompetente. Ai ka fajësuar Ministrinë e Ambientit për mosqartësimin e taksës ujore për prodhuesit e ujit. "Dy çështje kryesore që na përcjellin në këtë sektor janë çështja e taksës ujore dhe akcizës. I vetmi vend në rajon i cili ka ende akcizë në prodhimin e pijeve alkoolike është Kosova. Çështja e dytë që lidhet me këtë është taksë ujore. Kur është falur borxhi i asaj që

lidhet me taksën ujore është falur për shifra të larta rreth 50 milionë euro që realisht s'ka ekzistuar fare si problem për shkak se ky borxh nuk ka qenë i ndjekur nga Ministria e Mjedisit. Ajo që ka dalë në opinion është bazuar në një analizë dhe kjo analizë ka treguar që borxhi i këtyre kompanive mund të jetë 50 milionë euro, por mund të jetë edhe 200 mijë euro, varësisht nga kapaciteti prodhues dhe shitja e produkteve", është shprehur Rukiqi. Veç kësaj ai ka shpalosur idenë

për krijimin e një zyre që lehtëson komunikimin ndërmjet KEDS-it dhe bizneseve si përgjigje ndaj shqetësimeve të këtyre të fundit. "Nga dhjetë takime që kemi pasur ka dalë një problem kryesor, që është çështja e energjisë elektrike. Ne jemi duke hartuar një marrëveshje me KEDS-in që në Odën Ekonomike të Kosovës të jetë një qendër permanente e dhënies së këshillave për biznese sa iu përket çështjeve që lidhen me furnizimin me energji", ka thënë Rukiqi.

Gjithashtu, Rukiqi ka premtuar themelimin e Grupit të Komunikimit me Komunën e Prishtinës.

Ai në këtë konferencë për media ka folur edhe për TVSh-në. "Temë e rëndësishme është Ligji për TVSh-në. Tri elemente për këtë çështje janë: të eliminohen paqartësitë që i ka sjellë ligji i mëparshëm i ATK-së, të mblidhet TVSh-ja brenda vendit dhe jo në kufi, si dhe të krijohet një agjenci që merret vetëm me TVSh-në", ka deklaruar Rukiqi.



Veseli i premtton mbështetje Odës Ekonomike Amerikane për forcimin e sektorit privat

PRISHTINË, 6 GUSHT (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, është takuar të hënën me kryetarin e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka. Pas takimit, Veseli ka theksuar se modernizimi i ekonomisë nuk mund të ndodhë pa sektorin privat. Sipas tij, forcimi i sektorit privat ndihmon

rritjen e ekonomisë, rrjedhimisht perspektivën e të rinjve. "Modernizimi i ekonomisë nuk mund të ndodhë pa sektorin privat. Sektorin privat duhet të ketë prioritet, kjo është ajo të cilën bashkë e ndamë si mendim edhe me Odën Amerikane. Duke e forcuar sektorin privat, ne arrijmë të modernizohemi, ta rrisim

ekonominë tonë, perspektivën e të rinjve tanë që të qëndrojnë në Kosovë e assesi mos ta lëshojnë Kosovën pas liberalizimit të vizave", ka thënë Veseli. Ai ka bërë me dije se ka premtuar shqyrtim të ligjeve që u mundësojnë bizneseve të kenë ndikim në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Më 9 gusht bëhet tërheqja e fituesve me kupon fiskal

PRISHTINË, 6 GUSHT (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) më 9 gusht, duke filluar nga ora 08:30,

do ta bëjë tërheqjen e numrave potencialë fitues për rimbursim nga kuponët fiskalë, periudha TM2/2018.

Tërheqja e numrave potencialë fitues do të bëhet drejtpërdrejt në RTK, në kuadër të programit të

mëngjesit. Numri i përgjithshëm i qytetarëve të cilët kanë aplikuar për këtë periudhë është 55 493.

VAZHDONI TË
KËRKONI KUPONIN
FISKAL

Gruri po dergjet nëpër ara



Fushata e korrje-shirjes së grurit ende nuk ka përfunduar si pasojë e reshjeve të vazhdueshme të shiut

EPOKA
ERE

Ismail REXHEPI

FERIZAJ, PRISHTINË, LIPJAN, 6 GUSHT - Fushata e korrje-shirjeve të grurit, edhe pse thuhej se para 20 ditësh kishte hyrë në fazën përfundimtare, nuk doli ashtu. Ende nuk janë kryer më shumë se 60 për qind të sipërfaqeve që ishin me grurë. Deri te kjo erdhi si pasojë e reshjeve të përditshme të shiut, sidomos në kohën e korrjes së grurit. Të shumta janë grunajat që po dergjen nëpër ara. Të pakta janë ato grunaja që arritën të korren sivjet për shkak të lagështisë së madhe ku kombajna nuk ka mundur të hyjë. "Edhe sot disa

hektarë grurë janë të nxira që kanë mbetur pa u korrur te i vendi i quajtur 'Buqalla' afër hekurudhës dhe fshatrave Rubovc e Kojskë", ka bërë me dije bujku nga fshati Gumnasellë i Komunës së Lipjanit, Adnan Sadiku. Korrje-shirjet i ka penguar lagështia si pasojë e reshjeve të përditshme të shiut. Gruri ende gjendet i pakorrur dhe i tëri në ujë. Këto grunaja të pakorrura janë të bujqve të fshatit Llugaxhi të Komunës së Lipjanit, afër magjistrales Prishtinë -Shkup dhe fshatit Babush të Muhaxherëve. Jo larg këtyre grunajave është edhe fabrika e miellit, ku nga biseda me

pronarin mësojmë se sivjet kanë arritur të grumbullojnë pak grurë si pasojë që shumica e grurit edhe është nëpër ara.

Edhe pronarët e mullinjve si "Qali" dhe ai në fshatin Smallushë i kanë pohuar gazetës të dielën se sivjet ka shumë pak grurë që sjellin bujqit, sepse shumica e sipërfaqeve nuk janë korrur, si dhe ato të cilat ishin fshirë kanë pasur rendimente shumë të ulëta. Madje një bujk nga 70 ari me grurë kishte marrë vetëm gjashtë thasë.

Sivjet nuk kishte bereqet. Të rralla janë ato grunaja që për një hektar janë marrë 2 mijë kilogramë grurë. "Shkaktarë kanë qenë shirat e shpeshta, dëmtimet nga breshëri si dhe në periudhë të gjatë koha e vranët. Madje, sipas tyre, çka është edhe më e keqja, edhe ai grurë që merret është i cilësisë shumë të dobët", kanë pohuar pronarët e

mullinjve që gjenden në Komunën e Lipjanit.

Sipërfaqe të shumta të grurit të pakorrur që ende dergjeshin hasëm edhe në fshatin Cërnillë të Komunës së Ferizajt, në të majtë të rrugës në drejtim të hyrjes në këtë fshat. Edhe këtu na thanë se si pasojë e lagështisë së madhe nuk ka mundur të hyjë kombajna. "Pavarësisht prej kohës, më nuk ia vlen të korret gruri, sepse ai nuk jep asnjë rendiment. Me një fjalë, duhet paguar për korrje së koti", kanë pohuar bujqit në këtë fshat. Nga terreni mësojmë se gjendje e ngjashme mbretëron edhe në fshatin Sazli të kësaj komune.

Rrugëtimi ynë pas këtyre dy komunave ka vazhduar edhe në fshatrat e Gollakut të Komunës së Prishtinës, në Makovc, Grashticë, Koliq Keqekollë e Prapashticë. Edhe në këto fshatra malore gjendja pothuajse

ishte e njëjtë me fshatrat e rrafshit. "Edhe kur vera merrte e mirë, pra pa të reshura të shiut në afatin optimal të korrjeshirjeve në fshatin Keqekollë gruri korrej për shkak të kushteve atmosferike më se voni. Po ashtu, edhe rendimente të hairit kurrë nuk ka pasur. Mirëpo sivjet është shumë më keq, jo që nuk janë korrur grunajat, por ato s'kanë kokërr të bereqetit", ka thënë bujku nga fshati Keqekollë, Faik Ramadani.

Edhe në disa fshatra të Komunës së Shtimes kishte sipërfaqe të grurit të pakorrur. Gruri në sipërfaqe të mëdha po dergjej nëpër ara që ka mbetur pa u korrur.

Qytetarët e shumtë janë shprehur se kjo gjendje do të ndikojë edhe në rritjen e çmimit të miellit e të bukës, sepse shumë pak grurë është marrë sivjet nga arat e Kosovës.



A do ta shesë Kosovën Hashim Thaçi



Bedri ISLAMI

Në të gjithë këto ditë, pas një deklarimi të presidentit të Kosovës për korrigjimin e kufijve është ndezur, ndoshta me të drejtë, një debat i pafund rreth kësaj teze, e cila, si jam i bindur, kurrsesi nuk mund të jetë vetëm ide e Hashim Thaçit. Po ashtu, dua të besoj se, si ndodh zakonisht në nënzërat e politikës, ai duhet të ketë marrë një mendim nga strukturat që e mbështesin në botën e politikës. Dhe këto struktura janë të njohura.

Por, edhe sikur të ishte mendim vetjak i tij, ai, si po alarmohen analistët dhe njerëzit e politikës opozitare në Shqipëri, por edhe në Kosovë, as nuk e vendosi këtë, as nuk i vuri zjarrin kontinentit të vjetër, dhe as nuk ka fuqi të hapë atë që quhet Kutia e Pandorës.

Sidoqoftë unë e them haptas: nëse Ai arrin të bëjë atë çfarë ka në mendje, kthimin e Kosovës Lindore si pjesë integrale të Kosovës, le të hapen 100 kuti pandorash, të cilat janë mbyllur një mijë herë për vendin tonë dhe gjithnjë në dëm të tij. Mendimi i një politikani lësëist, se "kufijtë janë mirë", është naiv pasi, pas këtyre kufijve, shumë nga shqiptarët që bëjnë pjesë në shtetet rrethuese, sidomos në Kosovën Lindore, janë në prag të asgjësimit si pjesë formuese: ata po shpërngulen me dhunë, po mohohen të drejtat dhe vetë jeta e tyre është në rrezik.

Por të kthehem tek ideja e këtij shkrimi, "A do ta shesë Kosovën Hashim Thaçi"?

As Hashim Thaçi dhe askush tjetër nuk është sot zot i Kosovës dhe mbinjeriu që vendos për fatin e saj. Edhe nëse, në rastin më të hidhur, ai provon të bëjë lëshime mbi hartën e Kosovës, sado të vogla të jenë ato, përgjegjësinë historike dhe ndëshkimin kohor do ta marrë vetëm ai, por sigurisht se asgjë e tillë nuk do të mund të kalojë përmes Kuvendit të Kosovës dhe institucioneve të saj.

Ka shumë zëra se e gjithë kjo që po ndodh aktualisht në Kosovë, pra përplasjet dhe përdallimet e mëdha të klasës politike dhe rolit të Thaçit kanë të bëjnë me lëshimet e këtij të fundit ndaj strukturave euroatlantike për të qenë i sigurt se ndaj tij nuk do të veprojë

Gjykata Ndërkombëtare, e njohur si

Gjykata Speciale, e cila tani mund të ketë filluar t'i mbyllë dosjet e saj.

Të bësh politikë përmes një teze të tillë dhe të synosh të bësh të kapshëm mendimin se lëshimet e Thaçit kanë të bëjnë me "ruajtjen e kokës së tij" do të thotë që nuk ke kuptuar dy gjëra themelore: që bashkësia ndërkombëtare po vepron kundër Kosovës, përderisa kërkon lëshime politike e territoriale dhe, e dyta, të mos e njohësh mekanizmin që është vënë në lëvizje nga drejtësia ndërkombëtare, e cila, jo si në Kosovë e kurrë si në Shqipëri, nuk është institucion politik, nuk varet nga shefat e shteteve dhe as nuk do t'ia dijë se çfarë lëshimesh është i gatshëm të bëjë Hashim Thaçi.

Nëse ndaj tij, si ndaj kujtdo tjetër në Kosovë, ka fakte dhe saktësi se me emrin dhe luftën e tij janë të lidhur edhe krimet të ndryshme, kjo nuk ka të bëjë aspak, në asnjë çast, me lëshimet ose idetë që ka ndërmend presidenti i Kosovës.

Vetëm ata që në rrethana të ndryshme kanë bërë lëshime të tilla, qoftë politike, qoftë kombëtare, për më shumë hapësirë politike e jetësore, e perceptojnë Gjykatën Ndërkombëtare si një han ku futet e del secili që mbron apo dënon politika jashtë Kosovës.

Presidenti Hashim Thaçi nuk ka tagër të shesë asnjë metër katror të Kosovës. As të ndërrojë kufijtë e saj në rrudhjen e tyre. Dhe as nuk synon të bëjë këtë. Në mos tjetër, ai e di fare mirë që mbi fatin e tij, jo vetëm politik, por edhe mbi investimin e shkuar, varet një darë e fuqishme, përmes së cilës nuk mund të luash me asgjë tjetër, veç dobisë për shtetin tënd.

Kosova nuk është çiflig as i Thaçit, as i Mustafës, as i Haradinajt dhe as i Veselit. Ata e kanë radhën tani të qeverisin, por kjo nuk do të thotë se janë të përjetshëm në qeverisjen e tyre. Më mirë se gjithë të tjerët, këtë e dinë ata vetë.

Ata, secili prej tyre, është e mundur të luajnë me prona dhe tenderë, të vënë pasuri dhe të shpërrallisnin për patriotizëm por, shumë herë më tepër se një klan opozitar përreth tyre, ata, të cilët drejtojnë sot tre institucionet më të rëndësishme të Kosovës, në të shkuarën kanë dëshmuar më tepër përkushtim sesa disa "trima lëdëkëistë", të cilët në kohën e pushtetit të tyre e kishin për nder të ishin pjesë e bashkim-vëllazërimit serbojugosllav.

Kosova është mbi të gjitha krijesë e shteteve perëndimore dhe e politikës së tyre për Ballkanin.

Duke u nisur nga lufta që ndodhi në Kosovë dhe, pa këtë luftë nuk do të kishte ndërhyrje euroatlantike, ata synuan dhe arritën disa gjëra njëherësh, njëri nga të cilët do të ishte vendosja e kufirit të influencës ruse në kufirin verior të Kosovës.

Në rreth 20 vjet shtetet perëndimore kanë investuar më tepër nga sa është pritur dhe kanë ngritur një shtet, ndonëse çalamani për jo fajin e tyre deri në fund, i cili nuk ka as luksin, as dobësinë për të falur në paqe atë që është fituar me luftën e përbashkët.

Çështja e Kosovës, megjithëse është shtruar në një tryezë dypalëshe, nuk është vetëm e tillë. Ajo, në paskenat e saj, ka aktorë të tjerë, të cilët nuk kanë menduar vetëm sot për tezën e Presidentit të Kosovës dhe jo nga dita e sotme po synojnë për të realizuar një sovranitet gjithnjë e më të fuqishëm.

Ka të dhëna të plota se ajo që po diskutohet sot mes dy përfaqësuesve shtetërore është rrahur shumë herë në kancelaritë euroatlantike, është hapur jo vetëm si temë e nxehtë, por edhe si opsion për zgjidhje mes shteteve me qëndrime jo të njëjta, për të ardhur në këto ditë, kur gjërat po nxehen gjithnjë e më shumë dhe kur pritja bëhet e padurueshme.

Tagri i Hashim Thaçit është të përfaqësojë Kosovën në këto bisedime. Qëndrimi i opozitës që presidenti i Kosovës të mos jetë drejtuesi i tyre, sado gabime mund të ketë bërë Thaçi në të shkuarën dhe ai ka bërë, është si të kërkojë t'i lash duart dhe nesër të dalësh me teza nacionaliste, sikur vetëm qenia e tyre do të sillte një Kosovë dy herë më të madhe.

Të mos bëhemi të paditur: rolin e prijatarit, duam apo nuk

duam, Hashim Thaçi e ka marrë edhe kur ka qenë ndoshta i panjohur, si në Rambuje, e jo më sot që është në postin më të lartë të institucioneve të Kosovës.

Nëse opozita ka drojën se Thaçi mund të bëjë lëshime në dëm të Kosovës, është më e frytshme të jenë aty, ta ndalojnë në kohën e duhur dhe, nëse ai nuk do të kishte zgjidhje tjetër, ata të bëjnë të mundur përballjen e tij masive me opinionin publik.

Politika për Kosovën bëhet më shumë jashtë Prishtinës sesa në Prishtinë. Ajo i ka rrënjët nganjëherë shumë larg saj dhe nuk janë nga ato rrënjë që mund të lëvizin nga dëshira e një njeriu të vetëm, qoftë ky edhe presidenti i Kosovës.

Kosova e ka shpallur pavarësinë me propozimin e Kuvendit të saj dhe jo pa mbështetjen e atyre shteteve që qëndrojnë sot mbështetës të qëndrimit të shtetit të pavarur të Kosovës, pa i hequr asaj asnjë pjesë tokësore.

Si duket, mesazhi i ardhur nga Thaçi mund të jetë i nisur nga shumë larg, aq më tepër kur ai shoqërohet edhe dy mesazhe të tjerë, të cilët, analistët dhe opozita në Shqipëri, as nuk ka dashur dhe as nuk do t'i lexojë: nuk do të ketë ndryshime kufijsh, nuk do të jetë në diskutim asnjë metër katror tokë e Kosovës, pra nuk do të ketë ndarje.

Do të ketë përpjekje për një rishikim të kufirit. Nëse Thaçi e arrin synimin e tij, atëherë do ta ketë hak kujtesën e vendit të tij, do t'i harrohen mjaft gabime që ka pasur në rrugëtimin e tij politik; nëse e gjithë kjo është një shashkë vetëm e tij, atëherë përgjegjësia do të jetë vetëm e tij. Dhe më tepër se kaq, do të jetë një faj dhe fajet paguhen.

Ajo për të cilën bëhen merak analistët duke i qarë hallin gjithë botës, Kutinë e Pandorës së kufijve, nuk është në dorën e Hashim Thaçit, as të hapet, as të mbyllet e, as të hapet paksa, veç për Kosovën.

Në fund më lejohet të sjell fjalët e një miku tim, jashtëzakonisht të vyer, të cilit i kam besuar dhe do i besoj gjithnjë, pjesë e hershme e lëvizjes çlirimtare, i cili vjen pikërisht nga trevat e Kosovës Lindore, Halil Selimi.

Ai shkruan se:

Presheva kërkon trajtim serioz dhe zgjidhje politike të mirëfilltë.

Vetëm rikthimi në Kosovës është zgjidhje.

Mos të guxojë askush të tallet publikisht e as fshehtas me të drejtën historike, kombëtare dhe politike të një krahine dhe të një popullate të tërë, etnikisht e territorialisht pjesë integrale e Kosovës, padrejtësisht e shkapitur nga tërësia territoriale gjithëshqiptare.

Nuk i lejohet askujt që të vazhdojë ta përdorë Luginën e Preshevës si strehim apo mashtrim politik, e cila, pikërisht si pasojë e mashtrimeve të vazhdueshme historike për kusuritje, edhe ka mbetur deri sot nën Serbi.

Lugina e Preshevës (Kosova Lindore) ka mbajtur një referendum gjithëpopullor më 1-2 mars 1992, ku shprehet qartë vullneti politik për Autonomi politike-territoriale, me të drejtë bashkimi me Kosovën.

Kush është rizgjuar kombëtarisht dhe politikisht, le të mbështesin vetëm këtë vendim plebishitar të kësaj popullate lirisht, pa spekulime politike apo interesa individuale, kushdo dhe kudo qofshin ata.

Me mendimin e tij bashkohem plotësisht.



Hiroshima shënon përvjetorin e 73-të të sulmit me bomba atomike



TOKIO, 6 GUSHT - Hiroshima ka shënuar përvjetorin e sulmit me bomba atomike më 1945, me një ceremoni përkujtimi për personat e vdekur dhe të plagosur, duke bërë thirrje për eliminim të armëve bërthamore, në kohën kur po negociohet për denuklearizim të Koresë Veriore.

Udhëheqësi i Hiroshimas, Kazumi Matsui, ka përmendur agoninë e viktimave 73 vjet më parë dhe i ka bërë thirrje audi-

encës për të "dëgjuar sikur të kishin qenë aty më të dashurit tuaj". Më pas ai ka ngritur shqetësime për rritje globale të egocentrizmit dhe tensioneve, duke i bërë thirrje Qeverisë së Japonisë për të punuar drejt një bote pa armë bërthamore.

Sulmi amerikan në Hiroshima ka lënë të vdekur 140 000 persona dhe bombat në Nagasaki kanë shkaktuar vdekjen e 70 000 personave të tjerë tri ditë më vonë,

duke i dhënë fund Luftës së Dytë Botërore.

Më shumë se 50 000 persona, duke përfshirë banorë të Hiroshimës dhe përfaqësues të 58 shteteve, bashkë me ambasadorin amerikan William Hagerty, kanë qenë pjesë e ceremonisë së këtij viti. Të mbijetuarit, familjarët dhe pjesëmarrësit e tjerë, kanë shënuar përkujtimin me një minutë heshtje në orën 8:15, në kohën kur ka ndodhur sulmi më 1945.

Trumpi pranon qëllimin e takimit të djalit të tij me avokaten ruse

Takimi kishte ndodhur pasi një ndërmjetës rus i kishte thënë djalit të Trumpit se një zyrtar rus kishte dokumente që do ta dëmtonin rivalen e Trumpit në zgjedhje, Hillary Cilinton

WASHINGTON, 6 GUSHT - Presidenti amerikan, Donald Trump, ka pranuar se takimi i qershorit në vitin 2016 në Kullën Trump në Nju Jork mes ekipit të djalit të tij me një avokate të lidhur me Kremlinin është bërë për të pranuar informacione për kundërshtarë politikë mirëpo, sipas tij, gjithçka ka qenë "ligjore". Në një postim më 5 gusht, Trumpi ka thënë se takime të këtij lloji "janë bërë gjithmonë në politikë".

Sipas një dëshmie të Kongresit, në takimin e vitit 2016 kishin marrë pjesë djali i presidentit Trump, Donald Trump Junior, dhëndri i tij, Jared Kushner, udhëheqësi i fushatës së Trumpit atë kohë, Paul Manafort, avokatja ruse, Natalya Veselnitskaya dhe disa persona të tjerë.

Takimi kishte ndodhur pasi një ndërmjetës rus i kishte thënë djalit të Trumpit se një zyrtar rus kishte dokumente që do ta dëmtonin rivalen e Trumpit në zgjedhje, Hillary Cilinton.

Veselnitskaya ka kundërshtuar se ka punuar si përfaqësuese e Kremlinin kur është takuar me ekipin e Trumpit, duke i thënë Kongresit se ajo vepron "e pavarur nga trupat e tjerë qeveritarë". Mirëpo "Associated Press" kishte raportuar më 27 korrik se pas rishikimit të dokumenteve, është parë se Veselnitskaya ka punuar më shumë me zyrtarët rusë në krahasim me periudhat e

tjera.

Postimi i Trumpit në "Twitter" përbën deklaratën e tij më të drejtpërdrejtë sa i përket këtij takimi, ndonëse djali i tij dhe të tjerët kanë pranuar se në takim është diskutuar për mbledhjen e informatave për Clintonin.

Presidenti amerikan ka deklaruar më herët se në takim është diskutuar për adoptimin e fëmijëve rusë nga amerikanët.

Në "Twitter", Trumpi ka thënë se nuk është i shqetësuar nëse djali i tij mund të përballlet me procedura ligjore për këtë takim. "Lajme të rreme, fabrikim total është fakti se unë jam i shqetësuar për takimin e djalit tim fantastik, Donald, në Kullën Trump. Ky ka qenë takim për të marrë informata për një kundërshtar, takim

plotësisht ligjor, i cili bëhet në gjithë kohën në politikë", është shprehur ai.

Këshilltari special Robert Mueller është i angazhuar për të hetuar nëse ekipi i fushatës së Trumpit është koordinuar me Rusinë për ta kthyer rezultatin e zgjedhjeve në të mirë të tij. Trumpi deri më tani ka kundërshtuar çdo bashkëpunim me Moskën dhe ka cilësuar hetimet në ShBA si "gjuetinë më të madhe të shtrigave në histori".

Pse është kontrovers takimi në Kullën Trump?

Është e zakonshme për politikanët amerikanë të bëjnë kërkime për kundërshtarët e tyre gjatë fushatës. Megjithatë, ekspertë ligjorë kanë thënë se Trumpi Junior mund të ketë rënë në kundërshtim me ligjet për financim të fushatës, të cilat ndalojnë pranimin e gjithçkaje me vlerë nga ndonjë qeveri apo shtetas i huaj.

Gatishmëria e tij për t'u takuar në mënyrë që të pranojë informata për Clintonin mund t'i ketë thyer ligjet për komplot.

Një nga avokatët e Trumpit, Jay Sekulow, ka thënë të dielën se takimi nuk shkakton shkelje të asnjë ligji. "Pyetja është se cili ligj apo rregull është thyer? Askush nuk ka përmendur asgjë", ka thënë ai për "ABC News".

Presidenti rus Vladimir Putin ka hedhur poshtë akuzat se Qeveria e tij ka ndërhyrë në zgjedhje, pavarësisht prej të dhënave të agjencive amerikane të inteligjencës dhe atyre për zbatim të ligjit se Moska ka ndërhyrë në fushatën shtetërore, përmes e-maileve dhe manipulimit të opinionit publik.

Ish-drejtuari i fushatës së Trumpit, Paul Manafort, aktualisht është duke u përballur me gjyq në një gjykatë federale në Virxhinia për mashtrim bankare, ndonëse është raportuar se akuzat për të nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me ndërhyrjen ruse në zgjedhjet amerikane.



Carlos Barria (Reuters)

Daçiqi kritikon Izraelin

Beograd, 6 gusht - Ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Daçiq, ka kritikuar Izraelin, pasi avionët luftarakë të tij kanë marrë pjesë në manifestimet tradicionale në Kroaci në përvjetorin e 23-të të operacionit ushtarak "Oluja".

"Është e dhimbshme që flamuri i Izraelit dje valoi gjatë festimeve për një aksion kriminal", tha Daçiqi.

Tre avionë të tipit F-16 të Izraelit

morën pjesë në shënimin e përvjetorit të 23-të të operacionit "Oluja". Gjatë operacionit "Oluja", i cili ka zgjatuar katër ditë, forcat e armatosura kroate kanë kthyer kontrollin e pjesëve të Kroacisë, të marra nga serbët në fillim të vitit 1991.

Në të u vranë qindra civilë dhe vlerësohet se rreth 200 mijë serbë u detyruan të largoheshin nga shtëpitë e tyre.

Ambasada e Izraelit në Beograd tha se pjesëmarrja e avionëve izraelitë në këtë ceremoni është e lidhur vetëm me blerjen e avionëve izraelitë F-16 nga Kroacia, raporton AP. "Kjo nuk ka asnjë element politik apo lidhje me marrëdhëniet historike në mes të Serbisë dhe Kroacisë", citon të ketë thënë Ambasada izraelite në një deklaratë për agjencinë AP.

Miqësia "në mes të Izraelit dhe Serbisë", thuhet tutje në deklaratë, "nuk do të rrezikohet asnjëherë, në asnjë formë".

Por, Daçiqi tha se është e "pamoralshme" që Izraeli të marrë pjesë në këtë ceremoni, pasi dhjetëra-mija persona - shumica hebrenj, serbë, romë dhe kroatë antifashistë - u zhdukën në kampet e përqendrimit të udhëhequra nga regjimi kroat



gjatë Luftës së Dytë Botërore. Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, e ka krahasuar operacionin "Oluja" me ofensivën politike të Gjermanisë naziste.

Kush e urren Adem Demaçin e urren vetveten (2)

Adem Demaçi nuk e ka urryer kurrë Ibrahim Rugovën

(Shkruar në orën 21:00, pasi u mbyll e pamja për Adem Demaçin, më 31 korrik 2018)

Prof. dr. Hakif BAJRAMI

Adem Demaçi shpirtërisht e ka respektuar Ibrahim Rugovën, sidomos deri më 1 tetor 1997. Po e ka kritikuar sepse ka aspiruar që presidenti Rugova t'i mbathë çizmet dhe ta marrë komandën supreme me çka bota do të mësonte se një popull i tërë është ngritur me armë për luftë të drejtë. Pra, pozita e komandantit suprem për Adem Demaçin ishte princip dhe kriter real, sepse askush pa i rrokur armët nuk të ndihmon, as nga Lindja, jo se jo, por as nga Perëndimi, ku e kishim shpresën dhe orientimin politik dhe civilizues, sepse jemi evropian den baba den.

Në këtë rrafsh Adem Demën e gëzoj shumë fakti se KS i OKB-së më 31 mars 1998, tre muaj pas daljes publike të UÇK-së, u aprovua njëzëri rezoluta nr. 1160 ku, ndër të tjera, kishte mbështetje në kaptinën e VII (nenet 39-52) të Kartës së OKB-së, sidomos kur ishte në radhë neni 43, që do të thotë bombardime, gjithnjë duke u bazuar në intervenimin në Kroaci dhe në Bosnje. Mu për këtë, Baca e konsideronte shkruarjen në Rambuje një lojë të vjetër, të re evropiane. Këtë konfirmim e kishte nga goja e disa liderëve primarë në ShBA, fakt ky që duhet ta thonë ata. Lidhur me këtë Adem Dema e kishte të freskët shembullin e Kroacisë dhe të Bosnjës dhe nuk besonte se Milloshi do të jetë "civilizues" ndaj Kosovës, posaçërisht duke u bazuar në atë çka kishte ndodhur në Srebrenicë, zona këto në besë të OKB-së, aq më parë kur nga informatorët e tij kishte informatën për planin "Patkoi" të Milloshit që po i krijonte "korridorët përpalsës" të cilat i paralajmëroi me kohë Kiro Gligorov. Ndaj këtij paralajmërimi paria jonë politike në vend se të heshte kërkonte që Interpoli ta hetojë UÇK-në. Ku jeni shqiptarë, pse e fyeri Adem Demaçin, kur rreth një milion shqiptar u deportuan. Ky konceptim u forcua për Adem Demaçin, kur e lexoi dhjetëpikëshin e panegociueshëm, ku sovraniteti i Jugosllavisë mbi Kosovën ruhej, ku mbeteshin mbi 1 000 forca ushtarake dhe policore, ku kufiri me Shqipërinë ruhej sidomos kah Shqipëria nga armata Jugosllave. E dihet se Adem Demaçi kishte bërë burgje dhe kishte themeluar UÇK-në në saje të ndihmës së nënës Shqipëri, pikërisht ashtu si e kishte mësuar nëna Nazife dhe mësuesja Vezire - Shqipëria.

Baca fizikisht shkoi, a do të kemi bacë tjetër?

Isha në të pame për Bacën sepse e kisha shef 30 vjet dhe ia kisha borxh njerëzor si një ndër këshilltarët e tij. Ditën e 30 korrikut 2018

erdhi një ish-nxënës i imi i Gjinnazit (tash funksionar i lartë në Qeverinë e Republikës së Kosovës) në pamje me një grup burrash modestë. Foli ashtu si e do zakoni. Kur u ngrë, besova se si ish-profesor i tij do të më drejtohet personalisht për ngushëllime, sepse në gjinnaz kur ishte nxënës kisha guxim ta propagandojë jo vetëm Adem Demaçin, Atë Fishtë, por edhe kur recitohej himni shkollor: "Gaudeamus igitur", ku thuhej "vivat profesores, vibat Respublika..." si ndër hundë ia shtoja sufiksën e Kosovës. Nuk ka faj, thashë se e ka trullosur pushteti, por jo pasuria se atë ka ditur ta bëjë.

Dhe e lodha mendjen duke e pyetur vetveten: A më e madhe është pasuria e shqiptarit më të pasur sot në botë, plus pushteti, apo pasuria e Adem Demaçit, që nuk ka pasuri materiale fare. Nuk pata nevojë të mendoj shumë. Pasuria materiale e çdokujt mund të shuhet nga ndonjë e papritur natyrore, nga ndonjë keqmenaxhim prej tij apo pasardhësve. Pasuria e Adem Demaçit nuk mund të shuhet nga asnjë e papritur natyrore, as nga pasardhësit, as nga të gjithë shqiptarët sepse, nëse ne nuk e përvetësojmë, do ta marrin kombet e civilizuar. Ajo pasuri është e dukshme dhe merret fal, si gjenialiteti i Aristotelit, Mikelanxhelos, Skënderbeut, Galileut, Ajnashatjnit, Tesllës, Edisonit, Keplerit, Kopernikut, Khajamit, Gandit... Nënë Terezës, sepse kjo pasuri është në tregun e humanizmit dhe luftës së drejtë, kudo në glob.

Në të njëjtën ditë erdhën për kreshendosh edhe dy kryetarë komunash të Kosovës së bashku: Kryetari i Skenderajt dhe kryetari i Drenasit me shokë shumë. U printe me gëzimin tim djali i Hamëz Jasharit. Foli si burrat dhe thashë: Heroi Hamëz Jashari nuk paska ndërruar jetë, aq më parë kur Drenica heroike e kishte renditur të parin. Ju lumtë! Nja një orë më vonë erdhi pa protokoll, pa politikë, Rifat Jashari.

Foli edhe ky. Fjalë pak dhe domethënie brilante burrërie. Dhe, më lindi pyetja? Kush do ta zëvendësojë Bacën, të paktën si legjendë?!

Sikur e gjeta në bujarinë arbërore të Rifat Jasharit dhe shumë u gëzova si fëmija se do ta kemi dhe duhet ta promovojmë një Bacë shumë më të vogël, por Bacë sepse familja dhe sjellja arbërore bujare atë siguron.

Koha për dituri dhe nevoja që të kemi vatan ishte luftë e drejtë paralele, e pandarë.

Më 1945 në viset e robëruara shqiptare filloi seriozisht lufta për arsimim. Ajo luftë nuk ka qenë e lehtë, nga Abetarja e përkthyer deri tek universiteti dhe akademja e institutet shkencore. Ishte kjo luftë e veçuar sepse femrës, sido-

mos i jepej shansi të dalë nga robëria e dyfishitë. Nga ajo robëria na kanë nxjerrë mësuesit trima dhe të palodhshëm, librat dhe romanet e para shqip. Sidomos na ka zgjuar efektshëm romani i ndaluar "Gjarpitë e gjakut", lexuar pjesë-pjesë në "Jeta e re" e famëlartit Esat Mekulit. Nga ajo shkollë kemi dalë të gjithë. Pas ndalimit u bë libri më i lexuar për dekada, ilegalisht, dorë pas dore. Më 1 shtator 1969 kisha shkuar në Gjinnazin e Podujevës për të punuar si profesor i historisë. Ishte gëzim për mua si ish-nxënës gjinnazi të jam profesor, si Zekeria Rexha, si... Më 27 nëntor në mbrëmje do të mbahet një mbledhje dhe aty dy politikanë të komunës së Podujevës do të ma shtinë ndër hunde se "po kritikoj si Adem Demaçi"!

Mendova e meditova dhe pas dhjetë ditësh e lëshova punën dhe u punësova në Gjinnazin e Prishtinës, ku drejtori ishte një patriot, ku i kisha disa profesorë shokë, shumë të përkushtuar ndaj çështjes kombëtare. Aty, pas tre muajsh, do të ngrihet një serbian dhe do të na thotë në mbledhje të arsimtarëve: "Prof. Tahir Abdyli, prof. Rifat Blaku dhe prof. Hakif Bajrami kanë qenë në demonstratë më 27. XI. 1969 në Prishtinë".

Drejtori Fazli Sylja, pa një pa dy, do t'ia kthejë: "Po, por me detyrë (Da, ali po zadatku!)" duke e drejtuar gjithnjë kah gjoksi i vet.

Ishte ky prof Fazli Sylja. Me kaq nga drejtori autoritativ dhe zot i vërtetë i shtëpisë, akuza u mbyll. Kur dolëm nga mbledhja në kalim e sipër drejtori Fazli Sylja si në "tallje" na tha: "More problema, tjera herë kur të dilni mos shkoni pa mua, bre dertin jua kajsha"! Dhjetë vjet më vonë (15 janar 1979) kur e kisha marrë gradën doktor shkence në histori, prindi Fetah Bajrami do të më thotë: "Shkollë keni ba mjaft, por vatan atje ku po ju thërret Adem Demaçi nuk keni ba ende!"

U stepa. Nga viti 1983 po ai prind i pajtuar me nënën do ta ruajnë kseroksimin e dosjes Demaçi në magje të miellit. Dhe kur e pyeta a ka dobi për vatanin ruajtja e dosjes, më tha: "Po, ruaju, ke tash pozitë drejtori, por: shkau të blenë në pranverë, të mjelë verës, të pretë në vjeshtë e të hanë dimrit. Vatan i lirë dhe shkolla e Demaçit ta sigurojnë që shkau as mos me të ble, as mos me të mjelë, as mos me të pre e as mos me të hangër". Mësoni shqiptarë, nuk ka ardhmëri pa këtë shkollë të përvojës popullore - kombëtare. Kapitalin jetësor të Adem Demës duhet ta përvetësojmë. Baca diku e kishte lexuar se ilirët nuk kanë pasur skllavoprinari fare, sepse fisi nuk donte ta shtypte asnjë anëtar, e sidomos kujdeseshin për fisin tjetër që të jetojnë në miqësi. Së dyti, mësonte Baca shqiptarët nuk e kanë përjetuar kapitalizmin fare,



sepse koha po tregon se duke mos pasur si pasojë ndarjen territoriale, treg kombëtar ku plasohet malli dhe i konkurron mallit tjetër, ne kombëtarisht jemi vonuar. Së treti, kritikën, opozitën, duhet ta kuptojmë si pasuri civilizuese e jo si urrejtje. Unë (Baca) i kritikoj dhe më kritikojnë. Por, kjo nuk do të thotë më e shti ndër besë kritikuesin. Ejani ta marrim sikur tërë bota, nga kritika të dalim më unikë dhe më dinamikë në jetësimin e çështjes sonë kombëtare dhe civilizuese. Baca Adem Demaçi i shtypur deri më 1958; tmerrësisht i shtypur dhe i torturuar në burgje për 28 vjet; tmerrësisht i injoruar dhe anatemuar prej shqiptarëve, por edhe atyre që diktojnë me zarfe, prapë mbetet shkollë që mendon, flet dhe vepron për pajtim që nesër të jemi më të lirë dhe më të lumtur.

Si u shkatërrua krahura Jugosllavi?

Adem Demaçi është figurë tredimensionale që ka gjatësi, lartësi dhe gjerësi. Me një anë është shkatërrues i madh. Ja çfarë i thotë hetuesit kur thjesht e lutë: "A mendon për vete dhe për familjen tënde?" Baca: "Ju mendoni vetëm për shkatërrimin tuaj"! Mjaft për një epokë lufte që u zhvillua me emrin e tij.

Në bazë të dokumenteve që i kam konsultuar me shenja rezervat në arkivin e LKJ-së, mund të konkludohet se ishin këta faktorë që e shkatërruan Jugosllavinë integrale dhe "homogjene" titiste dhe serbiane-çetnike. Së pari do të ishte diskutimi i Eduard Kardelit më 1957 në Beograd kur thotë: "Është e natyrshme që ne sllovenët një ditë të shkojmë kah Austria dhe Italia sepse andej na drejton kultura; ju serbianët do të shkoni kah bota ortodokse sepse andej ju peshon kultura; Qosiqi nga salla e shqiptarët? Kardeli: Natyrshëm që

shqiptarët një ditë do të bashkohen me Shqipërinë".

Faktori i dytë pas aprovimit të Kushtetutës 1974 është kërkesa implicite që komanda ushtarake tutje të jetë në sllovenishte, në kroatishite, në serbishte, në maqedonishte, në shqipe për shkak të numrit të madh të rekrutëve. Kaq kësaj radhe.

Faktori vijues është sëmundja e Titos dhe "pëshpëritjet" kush do ta zëvendësojë. Si zëvendësues i parë përmes LKJ-së aspironte të jetë kriptokomunisti Staane Dollanc; si zëvendësues i parë përmes APJ-së aspironte të jetë Nikolla Lubiqiq. Ky e kishte bekimin serbo-malazez dhe maqedono-boshnjak. Nuk e kishte bekimin shqiptaro-hungarez.

Faktori i katërt do të bëhet evolutivisht kryesori e që është përplasia e shqiptarëve me pushtetin kolonial jugosllav, e që simbolikisht fillon me dukjen e LRBSH-së por, de fakto, më 27 nëntor 1968 me demonstratë shqiptare, e që kjo kohë si epoka e Adem Demaçit mbaron më 10. 6. 1999, kur "tallkinin" e fundit ia këndoi UÇK-ja dhe NATO-ja.

Për këtë shkollë ka jetuar dhe punuar baca Adem Demaçi, Mendela i shqiptarëve të robëruara nën Jugosllavi. Pra, krahura Jugosllavi ka shkuar në pakthim në muze. Vepra e Adem Demaçit është në rritje dhe lulëzim, sepse është luftë e drejtë, model ky që i frikësohen shumë regjime, por para tij tani për tani po dridhet edhe kontinenti i vjetër e lëre më kontinentet e tjera, edhe pse këtë frymë e djathta ekstreme po e lufton kudo, por "filladi" nacional ka filluar puhinë, këndshëm, lehtë, por sigurt, sikurse politika e Adem Demaçit. Le ta mbulojë botën sepse është në interes të shëndetit të njeriut, të lirisë dhe barazisë, sovranitetit dhe ardhmërisë. (Fund)

Prishtinë, më 31 gusht 2018

E jashtëzakonshme

Ura e ndërtuar nga 50 mijë shkopinj të bambusë

Ura mahnitëse, e gjatë një kilometër, në Kamboxhia është e ndërtuar nga 50 mijë shkopinj të fortë të bambusë. Ajo rindërtohet çdo vit nga banorët e vendit, shkruan "Daily Mail". Ura ndërtohet në kohë të thatë për ta lidhur qytetin Kampong Cham me një mijë familje që jetojnë në ishullin Koh Paen.



FOTO E DITES



Njerëzit shihen nëpër anije duke kaluar përmes ujërave nga përmbytjet në periferi të Hanoit në Vietnam. /AFP/

E rrallë

Dronët do t'i zëvendësojnë rojet e plazhit

Interesant, njëkohësisht edhe shumë efikas, është përdorimi i dronëve për shpëtimin e jetës së njerëzve kur ata gjenden në rrezik. Kjo është demonstruar në Australi së fundmi përmes një video se si përmes dronit mundësohet shpëtimi i dy personave nga valët e mëdha. Kjo formë testi duket se nuk do të mbetet vetëm në Australi, pasi në nëntor të këtij viti edhe Italia do t'i



prezantojë projektet e para në Sea Drone Tech Summit.

BARSOLETA E DITËS



Jeta
- A ke "Facebook"?
- Po.
- "Msn"?
- Po.
- "Skype"?
- Po.

- "Twitter"?
- Po.
- E jetë?
- Po kam edhe jetë, por ia kam harruar fjalëkalimin.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

"INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird




Në ora 18:20

"FUTURE WORLD" 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

"ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed



Në ora 22:00

"LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 min

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



DASHI

Keni guxuar më shumë sesa që


duhet këtë periudhë dhe sot do të jetë momenti që do t'ju duhet të merrni mbi vete të gjitha përgjegjësitë.



DEMI

Sot do t'ju duhet të jepni prova për altruizmin

tuaj, sidomos në raportet familjare. Do të hiqni dorë nga një gjë që e keni mjaft për zemër.



BINJAKËT

Keni kohë që jeni bërë viktimë të

konformizmit. Nëse gjërat do të ndryshojnë sot do të jetë një ndryshim për mirë.



GAFORRJA

Është një çështje që ju shqetëson prej

kohësh dhe sot ka ardhur momenti t'i jepni fund. Gjithë ky shqetësim do të duket sikur s'ka ekzistuar.



LUANI

Ka projekte që ju kanë zënë shumë nga

koha juaj dhe që do të kuptoni që nuk mund të realizohen. Filloni mbani distancë përpara se të jetë vonë.



VI RGJËR ESHA

Kontaktet që keni krijuar gjatë

karrierës suaj do t'ju ndihmojnë të merrni një vendim që po e shtyni prej kohësh. Çdo gjë do të shkojë mirë.



PESHORJA

Nëse nuk doni ta humbni mbështetjen

e personave pranë jush duhet të jeni më i pranishëm në jetën e tyre dhe t'i mbështesni në çdo hap.



AKREPI

Keni kohë që keni qëndruar në të njëjtin

vend pa bërë hapa përpara. Kjo gjendje po ju bën të ndiheni keq dhe të mbyllemi në vetvete.



SHIGJETARI

Keni zgjedhur mënyrën më të mirë

për të qenë vërtet të lumtur. Jeni të mbushur me optimizëm këtë periudhë dhe kjo ju ka ndihmuar.



BRICJAPI

Kohët e fundit keni qenë mjaft të zënë me

jetën tuaj private duke lënë pas dore impenjimet profesionale. Mund të krijojë ngecje në karrierë.



UJORI

Sot mund të merrni vendime shumë të

ndryshme nga sa keni thënë më parë. Kjo sepse në çdo moment do të keni ndryshime të situatave.



PESHQIT

Është mirë të mos komentoni

shumë idetë tuaja tek persona që sapo i keni njohur. Mund t'i përvetësojnë si të tyret.

Meghan vonon publikimin e albumit



Meghan Trainor ka njoftuar se albumi i saj i ardhshëm "Treat Myself" do të publikohet më vonë se që është pritur. Ky album ishte


planifikuar që të publikohet më 31 gusht, por Meghan e ka shtyrë datën. Pesë këngë të shkëputura nga aty tashmë janë në dispozicion në imunes.

Shqiptarët krenarë me Bebe Rexhën dhe Dua Lipën



Tashmë jemi dëshmitarë të shumë prej këngëtareve shqiptare me famë botërore, të cilat bëjnë krenarë shqiptarët kudo që janë. Të tilla janë Rita Ora, Bebe Rexha, Dua Lipa e Era Istrefi. Secila nga të lartpërmendurat janë të veçanta në stilin e tyre, e ndërsa ruajnë edhe

një miqësi shumë të mirë mes tyre. Së fundmi, Bebe Rexha ka pasur rastin ta takojë Dua Lipën në Festivalin "Lollapalooza" në Çikago. Ajo ka publikuar një fotografi në llogarinë zyrtare në "Instagram", ku shfaqet përkrah çikës së Kosovës, ndërsa shihet mjaft e lumtur që është takuar me të.



Rita Ora 'ndez' Lituaninë

Nuk ka pushime për Rita Orën. Bukuroshja me prejardhje nga Kosova e ka kombinuar relaksin në pishina apo buzë detit me koncerte shpërthyes në Londër, Nju Jork,

Milano dhe, së fundmi, është ndalur në Lituanë. E veshur e gjitha me jeshile, Rita duket shumë seksi në fotografitë që ka ndarë me fansat në rrjetin social në "Instagram" para koncertit.

Puthje pasionante në mes të Beyonces dhe Jay Z



Çifti i njohur i skenës, Beyoncé dhe Jay Z, kanë mbajtur së fundmi një koncert në New Jersey. Ky koncert ishte vonuar për pak për shkak të stuhisë, mirëpo gjithsesi fansat kanë pritur të gjithë deri në çastin kur dyshja u shfaqën

në skenë. Ata kanë bërë një hyrje madhështore në skenë pasi ka përfunduar stuhia. Për ta bërë edhe më emocionuese performancën e tyre, Beyoncé dhe Jay Z në një moment kanë shkëmbyer puthje pasionante me njëri-tjetrin.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

NOTTM FOREST - WEST BROM

3+

MIDDLESBROUGH - SHEFF UTD

GG

BROMLEY - DOVER ATHLETIC

1

Gashi: Besa nuk më ka kontaktuar, Vushtrria dhe Flamurtari po

Futbollisti Egzon Gashi ka mohuar kontaktet me Besën e Pejës, kurse ka konfirmuar kontaktet me Vushtrrinë dhe Flamurtarin. "Kontakte kam pasur me skuadrën e Vushtrrisë, por nuk kemi arritur marrëveshje për shkak të largësisë. Gjithashtu, kontakte kam pasur edhe me Flamurtarin, por nuk kam arritur marrëveshje për arsye personale. Ende jam lojtar i lirë", ka thënë ish-anëtari i Vëllaznimit, Egzon Gashi

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 6 GUSHT - Sulmuesi Egzon Gashi vazhdon të jetë lojtar i lirë ani pse ofertat nuk i kanë munguar asnjëherë. Sulmuesi pejan të hënën për "Epokën e re" ka bërë me dije se fillimisht ishte i fokusuar për të sqaruar të ardhmen e tij me Vëllaznimit e Gjakovës, kurse tash është duke u stërvitur individualisht për të qenë sa më i përgatitur për edicionin e ri futbollistik. "Oferta kam pasur edhe në kohën kur isha

pjesë e Vëllaznimit, por nuk kam vendosur asgjë derisa u sqarova me këtë skuadër për faktin se e kam ndier obligim moral, sidomos pas rënies në Ligën e Parë. Tash jam duke stërvitur intensivisht vetëm që të jam i gatshëm për skuadrën e re", ka thënë Gashi, i cili ka folur edhe për dy skuadrat që e kanë kërkuar në këtë afat kalimtar. "Kontakte kam pasur me skuadrën e Vushtrrisë, por nuk kemi arritur marrëveshje për shkak të largësisë. Kontakte kam pasur edhe me Flamurtarin, por nuk kam arritur marrëveshje për arsye

personale. Ende jam lojtar i lirë", ka shtuar ai. I pyetur se a ka pasur ofertë nga ish-skuadra e tij, Besa e Pejës, Gashi është përgjigjur: "Jo, deri tash askush nuk më ka kontaktuar nga Besa. Ka edhe disa skuadra që janë të interesuara, por nuk ka asgjë konkrete. Shumë shpejt do të përcaktohem për klubin e ri, por tash për tash më e rëndësishmja është të jam sa më i përgatitur fizikisht", ka deklaruar Gashi, i cili, përveç Besës dhe Vëllaznimit, në të kaluarën ka djersitur fanellën e Istogut dhe të Feronikelit.

SHKURT

Zyrtari i UEFA-s inspekton në çdo detaj stadiumin "Fadil Vokrri"

Një zyrtar i lartë i UEFA-s të hënën me fillim nga ora 10:00 e mëngjesit ka inspektuar stadiumin "Fadil Vokrri". Ai më pas do t'i japë rekomandimet se a i plotëson kushtet për ndeshje ndërkombëtare apo jo. Inspektimi është bërë pa praninë e medieve por, sipas "KTV"-së, inspektori i UEFA-s është ndarë i kënaqur me punët që janë kryer e që i ka inspektuar deri në orën 15:00. Ai ka shikuar në çdo detaj stadiumin e rinovuar dhe ka qenë në arenën "Fadil Vokrri" deri në orët e vona, duke e shikuar edhe ndriçimin. Inspektori i UEFA-s do ta japë vlerësimin e tij, ndërsa më 13 gusht do të merret vendimi final pas ndeshjen e Superkupës.

Drita e lë Gjilanin pa Shaqirin

Kampionia aktuale e Kosovës në futboll, Drita, ka arritur marrëveshje me mesfushorin Filonit Shaqiri, i cili të hënën i është bashkuar pjesës tjetër të ekipit. Shaqiri edicionin e fundit luajti për skuadrën e Gjilanit, kurse pas transferimit të Drita ai është shprehur shumë i kënaqur që tani është pjesë e kampionit dhe është i gatshëm ta ndihmojë ekipin për sezonin e ri.

Taib Kabashi rikthehet te Prishtina

Trajneri i njohur i hendbollit, Taib Kabashi, ka arritur marrëveshje me skuadrën e Prishtinës për edicionin e ri. Kabashi edicionin e kaluar kishte arritur një sukses të madh me skuadrën e Trepçës, duke e dërguar këtë klub për herë të parë në histori në garat ndërkombëtare. Taib Kabashi edhe në të kaluarën kishte qenë trajner i Prishtinës ku nga viti 2008 deri në vitin 2016 e udhëhoqi skuadrën kryeqytetase dhe fitoi shtatë trofe.

Witsel: Mezi pres të luaj për Dortmundin

Axel Witsel është rikthyer në Evropë pasi ka nënshkruar me Borussia Dortmundin. Skuadra gjermane do t'i paguajë Tianjin Quanjian klauzolën e lirim të lojtarit, e cila besohet të jetë rreth 20 milionë euro. "Pas Kupës së Botës, ishte qëllimi im për të lëvizur nga Kina në Evropë. Jam krejtësisht i lumtur dhe krenar që do të luaj për BVB së shpejti. Pas bisedës sonë të parë, nuk jam menduar dy herë, sepse për mua Borussia është një nga klubet më të mira në kontinent. Sinqerisht, nuk mund të pres që të luaj e të vrapoj përpara 81 000 njerëzve", ka thënë Witseli.

Javë vendimtare për KB Rahoveci

RAHOVEC, 6 GUSHT - Kjo javë është vendimtare për të ardhmen e KB Rahoveci. Pas rezultateve të mira, Rahoveci është duke u përballur me një krizë të madhe financiare dhe drejtuesit e klubit, të përkrahur edhe nga kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl

Latifi, kanë bërë thirrje që bizneset e këtij qyteti t'i ndihmojnë klubit, përndryshe ekziston rreziku i mospjesëmarrjes në gara. "Bordi i KB Rahoveci dëshiron të qartësojë se kjo javë është vendimtare për të ardhmen e klubit që bëri histori, ndërsa

mbështetja e bizneseve është e domosdoshme për vazhdimin e garave, tash kur klubi ynë po bëhet edhe me palestër. Bordi i KB Rahoveci ka kërkuar dhe kërkon nga të gjithë që janë të gatshëm për ndihmë ta përkrahin këtë projekt, në

mënyrë që puna e nisur të vazhdojë me sukses. Në tërësi këtë situatë bordi i KB Rahoveci do ta marrë vendimin për vazhdimin e garave ose jo, më së largu deri të enjten, kur është afati i fundit për regjistrimin e klubeve", thuhet në njoftimin e KB Rahoveci.

KB.RAHOVECI

Stadiumi i Prishtinës zyrtarisht quhet "Fadil Vokrri"

PRISHTINË, 6 GUSHT - Kuvendi Komunal i Prishtinës me 39 vota për dhe vetëm një kundër e ka miratuar propozimin për emërimin e Stadiumit të Prishtinës me emrin e ish-fut-

bollistit të njohur, Fadil Vokrri. "Stadiumi i rinovuar së fundmi do të mbajë emrin e ish-lojtarit të Prishtinës, Vokrri. Prej sot edhe zyrtarisht stadiumi i qytetit mban emrin Fadil Vokrri.

Faleminderit Kuvendit Komunal që miratoi propozimin e emrit", ka shkruar kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, në profilin e vet në "Facebook".

Fadil Vokrri ndërroi jetë javë më parë pas një sulmi në zemër, kurse gjatë udhëheqjes së tij futbollit i Kosovës u njoh në arenën ndërkombëtare, duke u pranuar në UEFA dhe FIFA.



Ademi: Do të bashkëpunojmë me FFShGj-së

PRISHTINË, 6 GUSHT - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, priti sot në një takim drejtuesit e Federatës së Futbollit Shqiptar për Gjermani (FFShGj), Enver Muzliukaj, Mustafë Bellaina dhe Safet Muzliukaj. "Bashkëpunimi ndërmjet FFK-së dhe FFShGj-së gjithmonë ka qenë në nivelin e duhur e ndërvellazëror që ka reflektuar edhe me bashkërenditjen e aktiviteteve të shumta sikur që tashmë është tradicional zhvillimi i ndeshjes revyale ndërmjet fituesit të Kupës së Kosovës dhe fituesit të Kupës së klubeve shqiptare në Gjermani dhe shumë aktivitete të tjera. Besoj se ky bashkëpunim do të vazhdojë dhe do të thellohet edhe më tej gjithnjë në të mirë të zhvillimit të futbollit dhe ruajtjes së marrëdhënieve të mira ndërmjet dy



institucioneve", ka thënë Agim Ademi. Ndërkaq, nënkryetari i FFShGj-s, Enver Muzliukaj, në emër të klubeve shqiptare të futbollit në Gjermani e ka uruar

presidentin Ademi për marrjen e postit të kryetarit të FFK-së, duke shprehur bindjen se bashkëpunimi do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Formula 1 ka nevojë për Mick Schumacherin

BERLIN, 6 GUSHT - E ardhmja e Mick Schumacher, djalit të shtatë herë kampionit të botës, Michael Schumacher, është në Formula 1. I këtij mendimi është Chase Carey, presidenti i Liberty Media dhe pronarit të garave të automobilizmit, që kërkon që piloti 19-vjeçar të garojë sa më shpejt në pistat e Formulës 1. "Prania e tij do të ishte speciale për sportin tonë, do të ishte një tjetër histori e bukur për t'u përjetuar dhe treguar", ka thënë Carey, që shpreson se emri Schumacher të nxjerrë nga kriza këtë sport. Mick Schumacher fitoi garën e parë sezonale në Formula 2, në pistën e Spa, në Belgjikë dhe kohët e fundit është përfolur shpesh për kalimin në Formula 1. Aty ku do t'i ndiqte gjurmët e babait të tij, që mban ende rekordin e 91 fitoreve në këtë



sport. Ndërkohë që, Michael vazhdon ende të jetë në periudhë rehabilitimi pas aksidentit me ski katër vjet më parë. "Michael ka qenë dhe mbetet një personazh unik në Formula 1, do të jetë gjithnjë ikonë e këtij sporti. Prania e djalit të tij, Mick, do të ishte e rëndë-

sishme për fansat, pasi do ta kenë pranë djalin e idhullit të tyre. Ka ardhur koha ta lehtësojmë mundësinë e afrimit të pilotëve të rinj në Formula 1", ka deklaruar Chase Carey, duke hapur "dritën jeshile" për ardhjen e Mick Schumacherit në garat e automobilizmit.

Cassano rikthehet nga pensionimi

Ish-sulmuesi i Romës, Real Madridit dhe Interit, Antonio Cassano, pritet të rikthehet nga pensionimi për të luajtur sërish në

Serinë A. "Jam i përgatitur dhe i gatshëm për t'u kthyer. Tashmë jam në bisedime me shumë ekipe, pasi kam marrë oferta nga

Bologna, Sassuolo, Parma, Torino e Cagliari", ka thënë Cassano, i cili vitin e kaluar ishte tërhequr nga futbollit aktiv.

SHKURT

Vidali prezantohet te Barcelona

Mesfushori Arturo Vidal është prezantuar te skuadra e Barcelonës. Ish-lojtari i Bayern Munchenit dhe Juventusit është shfaqur tejet i lumtur që do ta ketë rastin të luajë me lojtarë të mëdhenj siç janë Messi, Suarez dhe Busquetes. "Jam shumë i lumtur, është si në një ëndërr. Dua të bëj gjëra të rëndësishme këtu. Shpresoj të fitoj gjithçka. Ky është objektivi. Do të lë jetën në fushë për të arritur këtë. Para dhe mbrepa do të jap zemër dhe guxim. Dua të luaj me Messin, Suarezin dhe Busquetes. Ata janë të mëdhenj", ka thënë Vidal.

Gomezi largohet nga kombëtarja

Pas Mesut Ozilit, tashmë kombëtarja e Gjermanisë nuk do të ketë më as veteranin Mario Gomez, i cili nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale ka bërë me dije largimin nga përfaqësuesja. "E kam pasur për nder të luaja me Gjermaninë në Kampionatin Evropian dhe Botëror. Kam realizuar një ëndërr. Është koha për t'u lënë hapësirë të rinjve të talentuar, që edhe ata të mund ta realizojnë ëndrrën", ka thënë Gomez. Gjithsesi, në rreshtat e fundit të postimit të tij, Gomez e lë të hapur mundësinë e rikthimit, sigurisht vetëm nëse Low do të mendojë se ndihma e tij është e domosdoshme. "Do të kthehesha vetëm nëse do të ndihesh gati dhe trajneri do të kishte vërtet nevojë për mua. Gjithsesi është koha për t'i përshëndetur. Dashuria ime për Gjermaninë është e pamashë", ka deklaruar Gomez. 33-vjeçari, pjesë e Shtutgartit në Bundesligë, ka qenë pjesë e "Pancerave" që nga viti 2007, duke regjistruar 77 ndeshje dhe 31 gola.

Jesus: City është favoriti për titull

Braziliani Gabriel Jesus beson se skuadra e Manchester Cityt është favoriti kryesor për ta fituar titullin në Premier Ligë. "City mund të konsiderohet favoriti sepse është kampion aktual. Ne nuk mund ta arrijmë këtë me fjalë, por në fushën e lojës. Duhet të përqendrohemi në sezonin që do të nisë së shpejti. Ekipe të tjera janë forcuar, ndaj do të jetë e vështirë për të gjithë", ka thënë Jesus.

Giroudi kërkohet nga Marseille, por preferon qëndrimin te Chelsea

Kampioni i botës, Olivier Giroud, nuk ka aspak ndërmend të rikthehet në Francë. 31-vjeçari ka bërë me dije se për momentin nuk e mendon largimin nga Chelsea dhe se objektivi i tij është qëndrimi te skuadra e drejtuar nga Sarri. Ai ka respekt për skuadrën e Marseillet, por preferon të vazhdojë të jetë pjesë e skuadrës angleze edhe në edicionin e ri.

Honda vazhdon karrierën në Australi

Melbourne Victory e ka kompletuar transferimin Keisuke Hondas. Ylli japonez iu bashkua klubit si transferim i lirë. 32-vjeçari ishte pjesë e klubit meksikan, Pachucha, mirëpo pjesë më të madhe të tij si futbollist e ka kaluar në Evropë, në CSKA Moscow dhe Milan.

Shqipëria dhe Levante, 6 muaj pa Sadikun

Sulmuesi Armando Sadiku do t'i mungojë Kombëtares së Shqipërisë dhe skuadrës së Levantes për gjashtë muaj. Sulmuesi kuqezi është lënduar në ndeshjen miqësore ndaj Hereenveenit dhe klubi spanjoll njofton se ai do të jetë jashtë fushës për gjashtë muaj, pasi Sadiku fillimisht do t'i nënshtrohet një operacioni. Aktualisht Armando Sadiku është shënuesi më i mirë për Shqipërinë me 11 gola të realizuar.



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipality of Rahovec
Njësia e Personelit / Jedinica za Personal / Personnel Unit



01Nr./br.2281
Me dt./dana.06.08.2018.
Rahovec/Orahovac

Form. MAP- SHCK-02
Obraz. MJU-CSK-02

SHPALLJA E REKRUTIMIT / OGLAS ZA REGRUTACIJU

Institucion/ Komuna e Rahovecit / kërkon të punësoj në Drejtorinë për Administratë të Përgjithshme.
Institucija / Opština Orahovac želi da regrutuje u Odeljenje za Opšte Uprave.

Titulli i vendit të punës / Naziv radnog mesta:

- Zyrtar për Arkiv 4 - (1 pozitë)
- Službenik Arhive 4 - (1 položaj)

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës: A4-G11 / koeficienti i pagës 5.
Funksionalna kategorija i stepen radnog mesta: A4-G11/koficijent plate 5.

Numri i referencës së vendit të punës/ Broj preporuke za radno mesto : AK/170

Detyrat dhe përgjegjësitë/ Poslovi i odgovornosti :

[Shënoni saktësisht por me pak fjalë detyrat dhe përgjegjësitë kryesore/
(Ukratko i Tačno naznačite osnovne odgovornosti):
pranon dokumentet dhe lëndët për arkivim dhe kujdeset për arkivimin e tyre në përputhje me procedurat ligjore; 25%
siguron sistemimin dhe mbajtjen azhure të lëndëve arkivore, si dhe propozon udhëzues të nevojshëm për funksionimin e arkivit; 18%
përcakton në përputhje me ligjin mënyrën e mbajtjes së regjistrit arkivor dhe lëndëve arkivore; 17%
siguron që njësitë arkivore të jenë të shënuara me shenjat e përcaktuara sipas rregullave; 15%
përkujdeset për afatet e arkivimit të lëndëve, si dhe përgatit lëndët me afat të përhershëm për dorëzim në Arkivin e Republikës të Kosovës sipas dispozitave ligjore; 11%
ruan në vend të posaçëm disqet me shkresat elektronike dhe shkresat të natyrës në besim; 11%
përgatit raporte pune, mujore dhe vjetore; 2%
kryen edhe punë të tjera sipas kërkesës së cprorit që janë në pajtim me ligjin; 1%
vrši prijem dokumente i predmeta i stara se za njihovo arhiviranje u skladu sa zakonskim postupcima; 25%
stara se za svakodnevnu obnovu predmeta u arhivi, i predlaže potrebna uputstva za funkciju arhive; 18%
na osnovu zakona određuje način održavanje registra i predmeta arhive; 17%
obezbeđuje da arhivske jedinice budu ispisane sa određenim znakovima prema pravilima; 15%
stara se za rok arhive predmeta, kao i priprema i dostavlja predmete trajnih rokova pri Arhive Republike Kosova na osnovu zakonskih odredba; 11%
čuva na posebno mesto diskove elektronski spisa i strogo poverljive spise; 11%
izrađuje mesečni, periodični i godišnji izveštaj o radu -2%
vrši i ostale dužnosti prema zahtevu starešine, a koje su u skladu sa zakonom - 1%

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim / Uslovi za učešće na regrutaciji/

[Shënoni kushtet për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit sipas ligjit për shërbimin civil / Navedite uslove za učešće u procesu regrutacije po Zakonu o Javnoj Službi]

Kandidati përveç kushteve të lartë shënuar duhet ti plotëson edhe kushtet e përgjithshme të parapara sipas ligjit mbi shërbimin civil nr.03/L-149, si dhe ligjet e aplikueshme të Kosovës, të mos jenë nën hetime penale apo i dënuar për vepër penale. Kandidat osim gorenavezenih uslova treba da ispuni i opšte uslove predviđene zakonom o civilnoj službi br. 03/L-149, kao i Kosovskih zakona koji su u primeni, da nije pod krivičnom istragom ili kažnjen zbog krivičnog dela.

Procedurat e konkurrimit/ Postupak konkurisanja/

Shënoni nëse procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët të jashtëm si dhe nëpunës civil ekzistues ose nëse është procedurë e brendshme vetëm për nëpunës civil ekzistues/ Navedite ukoliko je procedura za konkurisanje javno objavljena i za javne službenike koji rade u instituciji ili je interna procedura za službenike koji već rade:

Procedura e konkurrimit është e hapur për nëpunësit civil ekzistues edhe për kandidatët e jashtëm. Postupak konkurisanja je otvoren kako za postojeće civilne službenike tako i za spoljne kandidate.

Shkollimi i kërkuar / Obrazovanja koje se zahteva/

[Shënoni shkollimin që kërkohet realisht për këtë vend pune/Upišite realno potrebno obrazovanje za obavljanje ovog posla]

Përgatitja shkollore : Diplomë universitare-drejtimi juridik, administrat, histori
Školska sprema: Univerzitetsku diplomu –smer prava, administracija, istorija

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen

/Veštine, iskustvo i druge osobine koje se zahtevaju.

[Përshkruaj aftësitë, përvojën dhe vetitë personale të cilat janë të kërkuara dhe të cilat mund të jenë të dëshiruara. Këto duhet të kenë lidhje me punën dhe të jenë objektive/Opišite sposobnosti, iskustvo i licne osobine koje se zahtevaju kao i one koje su poželjne. One treba da su u vezi sa radom i da su objektivne]: Njohuri profesionale specifike në fushën arkivimit të dokumenteve
Aftësi në zgjidhjen e problemeve për çështjet teknike ose procedurale që dalin nga procesi i punës
Aftësia për të organizuar punën e vet dhe për të koordinuar stafin e nivelit administrativ
Shkathtësi hulumtuese, analitike dhe të vlerësimit të informacionit
Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access)
Diplomë universitare-drejtimi juridik, administrat, histori, dhe minimum 4 vite përvojë pune

profesionale

Stručno specifično poznavanje oblast arhive dokumentacija

